

SHQIPËRIA

Partneriteti i Grupit të Bankës Botërore
Vështrim i Programit - Qershor 2014



WORLD BANK GROUP



Zyra e Bankës Botërore në Shqipëri
Rr. "Ibrahim Rugova", Nr. 34
Tiranë, Shqipëri
www.worldbank.org.al

Fotografia
Jutta Benzenberg
Design & Layout
Henrik Lezi

Tabela e Përmbajtjes

Zhvillimet e Fundit Ekonomike dhe Sektoriale.....	4
Programi i Bankës Botërore në Shqipëri.....	16

PROJEKTET E IBRD 18

Projekti për Modernizimin e Asistencës Sociale në Shqipëri	19
Programi i Menaxhimit të Integruar të Zonës Bregdetare dhe Pastrimit	20
Projekti për Administrimin dhe Menaxhimin e Tokës	22
Komuniteti Energjitik i Evropës Juglindore	24
Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes në Shqipëri	26
Garancia e Riskut të Pjesshëm (PRG) për Privatizimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë në Shqipëri	28
Projekti i Investimit në Sektorin e Ujit	30
Projekti i Menaxhimit të Përmirësuar të Burimeve Natyrore në Shqipëri	32
Shqipëria: Fondi i Besimit Shumëdonatorësh për Sistemin e Planifikimit të Integruar... ..	34

PROJEKTET E IFC 36

Projekti i Efiçencës së Energjisë për Banesat	37
Hidroçentralet e Vogla në Shqipëri dhe Energjia e Rinovueshme (ER)	38
Shqipëria: Projekti i IFC-së në Ballkanin Perëndimor për Logjistikën e Tregtisë	40
Shqipëria: Programi i Evropës Juglindore për Transparencën dhe Thjeshtëzimin e Taksave..	42
Shqipëria: Zgjidhja e borxhit	43
Shqipëria: Enso Hydro Energji.....	44
Shqipëria: Banka Credins	45
Shqipëria: Bankers Petroleum.....	46
Shqipëria: Union Bank.....	47
Shqipëria: Kurum International.....	48

PROJEKTET E MIGA-S


Shqipëria: Energji Ashta sh.p.k.....	51
Shqipëria: Mbulimi i Detyrueshëm i Rezervave të Grupit ProCredit nga Banka Qendrore.....	52
Shqipëria: Giorgi Alfo sh.p.k.....	54

ZHVILLIMET E FUNDIT EKONOMIKE DHE SEKTORIALE

Rritja ekonomike e Shqipërisë vazhdon të mbetet e tkurrur që prej krizës globale financiare të viteve 2008-2009. Një dekadë para-krizës ekonomia u rrit me një normë mesatare rritjeje prej 6%. Kjo rritje ra në 2.4% ndërmjet vitit 2009 dhe 2013. Kriza, që fillimisht u përhap përmes kanaleve financiare dhe llogarisë rrjedhëse, preku më tepër ato sektorë të ekonomisë që kishin kontributin më të madh tek rritja, veçanërisht sektorin e ndërtimit. Kriza zbuloi një sërë dobësish që ishin grumbulluar më parë në sektorin publik, financiar dhe të jashtëm. Zhbilancat fiskale u rritën dhe rreziqet në sektorin financiar u përshkallëzuan.

Rritja mbeti e dobët edhe në vitin 2013, me një rritje të PBB reale të përlogaritur në rreth 0.7%. Rënia e prodhimit u shpërnda në të gjithë sektorët ekonomikë, përveç bujqësisë. Ndërtimi ra me 10% në terma vjetorë për shkak të rënies së investimeve publike dhe kërkesës private. Industria ra me 4.6% në terma vjetorë, kryesisht për shkak të rënies së industrisë prodhuese, ndërkohë që industria nxjerrëse si edhe vlera e shtuar e sektorëve të energjisë, ujit dhe karburanteve u rritën paksa. Shërbimet u tkurrën me 2%, duke reflektuar kryesisht aktivitetin e ngadalhtë turistik gjatë të njëjtit tremujor. Duke parë përpara, rritja pritet të rikthehet në 2.1% në vitin 2014, si rezultat i përmirësimit të likuiditetit dhe kushteve financuese

TREGUESI I PRIRJES EKONOMIKE DHE RITJIA REALE E PBB




Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, projeksionet për 2013

për sektorin privat nga shlyerja e detyrimeve të prapambetura si edhe përmirësimit të kërkesës së jashtme për eksporte. Megjithatë, rreziqet thelbësore mbeten dhe rritja pritet të jetë poshtë potencialit në periudhën afatmesme.

Zhbilancat e jashtme po përmirësohen, por mbeten ende të larta dhe të ndjeshnme ndaj zhvillimeve të sektorëve specifikë. Ndërmjet 2009 dhe 2013, Deficiti i Llogarisë Rrjedhëse (CAD) ra me 5 pikë përqindjeje të PBB dhe aktualisht është 9%. Rënia rezultoi kryesisht për shkak të ngadalësimit dhe dobësimit të kërkesës së brendshme, që çoi në rënie të importeve.

Inflacioni mbeti i ulët ndërmjet vitit 2009 dhe 2013, afër 2 përqindëshit, për shkak të kërkesës së dobët dhe presioneve të importuara të inflacionit. Çmimet e prodhuesve u rritën me ritëm të ngadaltë dhe leku mbeti afër nivelit të 140 kundrejt euros gjatë të njëjtës periudhë.



Performanca Fiskale

Borxhi publik ka vijuar të rritet që prej krizës. Rritja e borxhit publik rezultoi si nga politika fiskale e liruar ashtu edhe nga shoku i jashtëm. Në vitin 2008, borxhi publik i Shqipërisë ishte i barabartë me 54.7% të PBB-së. Ligji Organik i Buxhetit, i amenduar në 2008, vendosi një lloj kufiri ligjor mbi borxhin publik, që është i barabartë me 60% të PBB. Në vitin 2011, politika e lirët fiskale, kombinuar me zhvlerësimin e lekut, rezultoi në rritjen e borxhit publik në 60.3%. Presionet fiskale u rritën më tej gjatë 2012 dhe 2013, për shkak të mbështetjes së kompanisë së prodhimit të energjisë dhe shpenzimeve elektorale. Në fund të vitit 2012, Parlamenti hoqi limitin prej 60% të borxhit publik, pa e zëvendësuar atë me ndonjë tjetër ankorë fiskale apo borxhi. Në vitin 2013, borxhi publik u rrit me më tepër se 8% të PBB-së – për shkak të deficitit të madh fiskal si rezultat i të ardhurave më të ulëta nga sa pritej dhe shpenzimeve më të larta krahasuar me pritshmëritë (që lidhen përgjithësisht me zgjedhjet), njohja e një grumbulli borxhi pagesash dhe një

rishikim të rënies së PBB – që arritën deri në 70.5% të PBB që prej fundit të vitit 2013. Qeveria ka akumuluar pagesa të mëdha buxhetore që arrijnë në 5.3% të PBB-së në fund të vitit 2013. Pjesa më e madhe përbëhet nga fatura të papaguara për punët publike të kontraktuara dhe pagesa buxhetore që lidhen me shëndetësinë (shumica ilaçe), arsimin, ujin, taksat mbi vlerën e shtuar (TVSH), ripagimi i taksave mbi të ardhurat e korporatave (CIT), faturat e energjisë elektrike dhe përfitimet sociale.

Qeveria e re ka miratuar një program konsolidimi fiskal afatmesëm duke filluar me buxhetin e vitit 2014, që prezantoi masa fiskale si tek të ardhurat ashtu edhe tek shpenzimet. Qeveria ka filluar edhe reformat strukturore (në energji dhe pensione) për të nxitur rritjen dhe përmirësuar manaxhimin financiar publik, duke përfshirë implementimin e një strategjie për pastrimin dhe parandalimin e borxhit. Autoritetet janë angazhuar me Bankën Botërore për mbështetjen e këtyre reformave nën Huanë e Zhvillimit të Politikave programatike. Në 28 shkurt 2014, bordi i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) miratoi një marrëveshje të Fondit të zgjeruar për Shqipërinë, që do të ofrojë mbështetje buxhetore në shumën prej 330.9 milion euro (rreth 457.1 milion \$) për një periudhë 3 vjeçare. Programi i FMN-së mbështet reformat strukturore që lidhen me pagimin dhe parandalimin e detyrimeve, zgjidhjen e huave të këqija (NPL), mbikqyrjen e sektorit financiar, zhvillimin e tregut të brendshëm të borxhit dhe sistemin e sigurisë sociale.


Sektori financiar

Sektori financiar ka mbetur gjerësisht i qëndrueshëm pavarësisht krizës së eurozonës, por sektori ende përballet me rreziqe të konsiderueshme prej presioneve nga bankat e huaja, rritjes së dobët të tejkriatur dhe përkeqësimit të vazhdueshëm të cilësisë së huave bankare. Sektori bankar përballet

me disa rreziqe që lidhen me një mjedis të pasigurtë makroekonomik, normat e larta dhe në rritje të NPL-ve, euro-izimin e lartë financiar dhe rreziqe fiskale që i përkasin një nivel të lartë mbajtjeje të letrave të borxhit qeveritar. Presionet e mëtejshme nga tërheqja e flukseve të huaja mund të rezultojnë nga Vlerësimi Gjithëpërfshirës i Bankës Europiane Qendrore i cilësisë së asetit të bankave kryesore të eurozonës, që do të fillojnë në gjysmën e parë të vitit 2014, që në këmbim do të influencojë pengesat e kapitalit në filialet e tyre, që operojnë në Shqipëri. Pronësia e huaj është rreth 90%, përgjithësisht e mbajtur nga bankat mëmë në Bashkimin Evropian (BE), gjysma e të cilave janë greke ose italiane.

Portofoli i papaguar i NPL-ve në fund të vitit 2013 ariti 24.2% të huave totale, me pasoja negative për rritjen e kredisë. Deri në nëntor 2013 kredia për sektorin privat u kontraktua nga 3.1% (vit pas viti) dhe rritja e depozitave mbeti e ulët, në 2.2% (vit pas viti).

Pavarësisht NPL-vë të shumta, bankat mbeten të shëndetshme me një raport përshtatshmërie prej 17.8% në fund të dhjetorit 2013. Megjithatë, përfitueshmëria e sektorit bankar e matur nga rikthimi i aseteve mbeti i ndrydhur si rezultat i kërkesave të depozitave dhe fitimet në rënie.



Banka e Shqipërisë (BSH), si rregullator dhe mbikqyrës i sistemit bankar, ka qenë proaktiv në miratimin e masave të kujdesshme për të ruajtur qëndrueshmërinë financiare.

Këto përfshijnë rritjen e normave të likuiditetit dhe kërkesat e kapitalit për disa banka si edhe masa që i drejtohen reduktimit të stokut të NPL-ve. Masat që i drejtohen reduktimit të NPL-ve (që janë miratuar ose janë në proces), përfshijnë: (i) publikimin e kohëve të fundit të Bankës së Shqipërisë të ristrukturimit të ri të borxhit dhe udhëzimet e vlerësimit dhe udhëzimet e reja për të nxitur shitjet e NPL-ve; (ii) zgjidhjen e ambiguitetit të taksës që vazhdon prej shumë kohësh sa i përket fshirjes së borxheve; (iii) reformën në gjyqësor për të përmirësuar regjimin e paaftësisë së pagesave, ekzekutimin e kolateralit dhe strukturën e incentivave private të përbarimit si edhe (iv) mbështetjen e asistencës teknike për zhvillimin e strategjive të reduktimit të portofolit të NPL-ve dhe një kornizë për ristrukturimet vullnetare të borxhit. Banka Botërore ka ofruar asistencë teknike për reformat ekzistuese, duke përfshirë një sërë masash për reduktimin e nivelit të NPL-ve. Një hua politikash zhvillimi për modernizimin e sektorit financiar (DPL) prej 100 milionë dollarësh u aprovua nga Bordi i Drejtorëve të Bankës Botërore në maj 2014 për të mbështetur programin e qeverisë për forcimin e sektorit financiar dhe reduktimin e vulnerabiliteteve kryesore.

Papunësia dhe varfëria

Performanca e mirë ekonomike e Shqipërisë para vitit 2008 u shoqërua me ndryshime pozitive në punësim dhe një reduktim të fortë të normave të varfërisë që janë përmbytur pjesërisht që prej asaj kohe nga kriza ekonomike globale. Performanca e mirë ekonomike para kthesës ekonomike globale u shoqëruar nga një reduktim mbresëlënës në varfëri. Niveli i varfërisë ra nga 25% në vitin 2002 në 12% në vitin 2008 dhe varfëria rurale edhe më shumë, nga 40% në 15% për të njëjtën periudhë.

Megjithatë, efektet e krizës globale dhe të eurozonës si edhe rritja e moderuar duket se e kanë rikthyer rritjen e varfërisë. Të dhëna nga studimi për matjen e standardeve të jetesës (LSMS) për vitin 2012 tregojnë se norma e varfërisë është rritur në 14.3% që prej vitit 2008. Popullsia në nivelin ekstrem të varfërisë, përkufizuar si ata me vështirësi në përbushjen e nevojave bazike ushqyese, u rrit nga 1.2% në vitin 2008 në 2.2% në vitin 2012. Varfëria ekstreme është rritur si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale. Ky zhvillim mbështetet gjithashtu nga të dhënat e punësimit të Sondazhit mbi Forcën Punëtore, që tregon se 27% e familjeve shqiptare kanë pasur të paktën një anëtar që ka humbur vendin e punës, përkundrajt mesatares prej 18% në Evropë dhe Azinë Qëndrore. Të dhëna të disponueshme mbi nivelin e papunësisë tregojnë se është rritur nga 12.5% në vitin 2008 në 16.9% në vitin 2013, me papunësinë ndër të rinjtë që ka arritur 26.9%. Hendeku i vazhdueshëm i prodhimit si edhe stagnacioni në tregun e punës janë reflektuar gjithashtu në prirjen rënëse të nivelit të pjesëmarrjes së forcës punëtore.

Ka pasur progres në ndërtimin e një rrjeti të mbrojtjes sociale për të varfërit. Masa të mëtejshme janë planifikuar për të përmirësuar barazinë, efikasitetin, transparencën dhe efektivitetin në përdorimin e burimeve për mbrojtjen sociale. Ndihma Ekonomike (NE) është programi i asistencës sociale për varfërinë me përfitim në para, që ofron ndihmë mujore për rreth 7.3% të popullsisë (rreth 100 000 familje) mbi bazën e kontrollit të nevojës. Rreth një e katërta e shpenzimeve totale për asistencën sociale në Shqipëri (1.6% e PBB) i dedikohet ndihmës Ekonomike (0.4% të PBB). Ndërkohë, 20 përqindëshi më i varfër i përfituesve marrin 56% të gjitha transfertave të Ndihmës Ekonomike, ndërsa në programet më të suksesshme të asistencës sociale në rajonin e Evropës dhe Azisë qëndrore të paktën 80% e përfitimeve arrijnë 20 përqindëshin më të varfër të popullsisë. Qeveria, me mbështetjen

e Bankës, ka nisur reformimin e programit për të përmirësuar lidhjen e tij me varfërinë, si në terma të transfertave nga niveli qëndror tek bashkitë ashtu edhe në përzgjedhjen e përfituesve në nivel bashkie.

Banka ka mbështetur mbrojtjen sociale në Shqipëri përmes dy projekteve që tashmë kanë përfunduar: (i) Projekti i Ofrimit të Shërbimeve Sociale, që ka ndihmuar në rritjen e aksesit të grupeve të popullsisë vulnerabël tek shërbimet efektive të kujdesit shoqëror dhe përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit të pensioneve si edhe (ii) Huaja për Zhvillimin e Politikave të Sektorit social (DPL), që mbështeti ndryshimet institucionale dhe të politikave për të përmirësuar efikasitetin e rrjetit të sigurisë shoqërore. Një projekt në vijim është ai për Modernizimin e Asistencës Sociale, i cili po mbështet asistencën sociale dhe reformën e aftësive të kufizuara. Një grant i Fondit Japonez të Zhvillimit Social mbështeti fuqizimin dhe programet e punësimit për të rinjtë në dy bashki kryesore.

Sektori i shëndetësisë

Shërbimet shëndetësore janë përmirësuar, megjithatë mund të bëhet më shumë në mënyrë që të sigurohet akses universal edhe nga familjet e varfëra. Shqipëria shpenzon rreth 2.6 përqind të PBB-së në kujdes shëndetësor, çka është shumë më pak se vendet me nivele të ardhurash të ngjashme (4.5 përqind të PBB-së). Kontributi i sektorit publik është relativisht i ulët, shumë më poshtë mesatares së Evropës Juglindore (EJL). Si rezultat i shpenzimeve të ulëta të sektorit publik, shpenzimet jashtë xhepit në pikën e shërbimit përbëjnë rreth 60% të financimit sektorial. Niveli i lartë i shpenzimeve të drejtpërdrejta të ekonomisë familjare tregon se sistemi ekzistues shëndetësor i ofron mbrojtje të kufizuar popullsisë ndaj sëmundjeve apo dëmtimeve dhe lejon vetëm një shpërndarje të kufizuar burimesh për mbrojtjen e grupeve më të prekshme



nga shoku shëndetësor. Barrierat ekonomike që hasin të varfërit për të patur akses në shërbimet cilësore, përkeqësohen nga mungesa e mbulimit të sigurimeve shëndetësore. Qeveria po punon për zhvillimin e një politike financuese shëndetësore që do të adresojë të gjitha këto probleme, bazuar edhe mbi një studim rajonal të Bankës mbi financimin shëndetësor.

Banka ka mbështetur sektorin e shëndetësisë në Shqipëri përmes Projektit për Modernizimin e Sistemit Shëndetësor që ka përfunduar dhe që ka asistuar qeverinë në përmirësimin e aksesit fizik dhe financiar tek shërbimet primare shëndetësore me cilësi të lartë dhe në forcimin e institucioneve. Huaja për Zhvillimin e sektorit social (DPL) mbështeti reformat për arritjen e eficiencës dhe barazisë së shërbimeve shëndetësore dhe mbrojtjen më të mirë të të varfërve nga shoku shëndetësor, duke përfshirë reformat në sigurimin shëndetësor, në një mjedis të qëndrueshëm nga ana fiskale. Një projekt i ri mbi shëndetësinë është ende në fazën përgatitore.

Arsimi

Rëndësia e arsimit dhe forcës punëtore të specializuar si për vetë individët ashtu edhe për zhvillimin ekonomik njihet mirë në Shqipëri. Për rrjedhojë, reformat e mëdha dhe gjithëpërfshirëse kanë filluar vitet e fundit, duke përfshirë: (i)

reformën e kurrikulave, për ta bërë atë më modulare dhe relevante, duke prezantuar gjithashtu një kurrikul moderne për teknologjinë e informacionit dhe teknologjisë (ICT) në shkollat fillore dhe të mesme, duke i pajisur të gjitha shkollat me laboratorë kompjuterash dhe akses në internet dhe duke ofruar laboratorë shkencorë për shkollat fillore dhe të mesme; (ii) përmirësimin e trajnimit të mësuesve për t'u siguruar se metodat e mësimdhënies fokusohen më tepër tek krijeshmëria dhe diskutimi sesa tek transmetimi jokritik i dijes; (iii) shpërndarjen më e barabartë e burimeve përgjatë rajoneve të ndryshme; (iv) përmirësimin i kushteve të mësimnxënies, me më pak klasa të mbipopulluara dhe më pak nevojë për turne në shkolla; (v) rritjen e pagave mesatare të mësuesve dhe (vi) riorganizimin e përbajtjes dhe administrimit të provimeve të maturës që jepen me largimin nga shkolla e mesme, për të përmirësuar relevancën dhe siguruar rezultate objektive. Të gjitha këto reforma vijojnë të zbatohen.



Reforma të rëndësishme kanë filluar edhe në arsimin e lartë. Fokusi ka qenë tek adoptimi i procesit të Bolonjës për një arsim modular që përputhet me atë europian, rritjen e numrit të studentëve në arsimin e lartë dhe prezantimin e programeve të shkurtra në universitetet rajonale. Ekziston gjithashtu një fokus tek rritja e eficiencës dhe llogaridhënies së institucioneve të arsimit të lartë, duke prezantuar gjithashtu një formulë

të rishikuar të financimit për student, duke themeluar borde të jashtme këshillimore, duke vendosur një sistem akreditimi për universitetet dhe duke zhvilluar procedurat e renditjes së universiteteve.

Banka ka mbështetur një gamë gjithëpërfshirëse reformash në arsimin e lartë në Shqipëri përmes Projektit për Cilësi dhe Barazi në Arsim (EEEP), që është financuar gjithashtu nga Banka Europiane e Investimeve, Banka e Zhvillimit të Këshillit të Evropës (CEDB) si dhe me një kontribut të qenësishëm nga qeveria. Mbështetja e Bankës Botërore për EEEP-në u mbyll në 30 qershor 2013 dhe programet e BEI dhe CEDB u mbyllën në 31 dhjetor 2013. Mësime të rëndësishme të nxjerra do të shërbejnë gjatë angazhimeve të ardhshme në këtë sektor.

Bujqësia

Bujqësia shërben si burim kryesor punësimi dhe të ardhurash në zonat rurale, duke kontribuar me 21% në PBB-në e vendit. Sektori bujqësor në Shqipëri është dominuar nga sipërmarrje të vogla private që prej rënies së komunizmit në vitin 1991, kur fshatarët fermerë shpërbënë fermat kolektive gjysëm shtetërore. Aktualisht ka rreth 324 000 biznese bujqësore, secila me një mesatare prej vetëm 1.1 hektarë toke të punueshme në çdo katër parcela. Përveç të korrurave, rreth 70% e fermave kanë edhe gjë të gjallë. Gjatë 10 viteve të fundit ka pasur një prirje të lehtë rënieje në zonën rurale që i kushtohet të korrave, me një rënie të madhe në drithëra, kompensuar pjesërisht nga rritja e zonave nën foragjere dhe në një masë më të kufizuar me perime.

Sfidë përbën transformimi i bujqësisë nga prodhimi i orientuar drejt mjeteve të jetesës në një sektor më modern dhe komercial, duke nxitur ndërkohë mundësi alternative të ardhurash për banorët e zonave rurale që e braktisin këtë sektor. Konkurrueshmëria mund të përmirësohet përmes rritjes së prodhueshmërisë dhe produkteve me cilësi më të lartë.



Në të njëjtën kohë, reforma e politikave bujqësore duhet të ndërmerret në kontekstin e kërkesave aktuale dhe të ardhshme të BE-së, duke përfshirë harmonizimin me legjislacionin dhe standardet e BE-së.

Banka ka mbështetur bujqësinë në Shqipëri përmes financimit të investimeve në ujitje, ekspozimit ndaj teknologjive dhe praktikave të reja dhe përmirësimit të aksesit më cilësor të tregut dhe gjithashtu përmes pilotimit të një programi të vogël grantesh që u replikua edhe nga qeveria. Aktualisht, Banka po financon projektin për Burimet Ujore dhe Ujitjen, që ka për qëllim vendosjen e një kornize strategjike për të menaxhuar burimet ujore në nivel kombëtar dhe në bazenet e lumenjve Drin-Bunë dhe Seman dhe për të përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme performancën e sistemeve të ujitjes në zonën e projektit.

Mjedisi

Qeveria e Shqipërisë po implementon një gamë të gjerë politikash në fushën e mbrojtjes mjedisore dhe manaxhimit të burimeve natyrore, duke i sjellë ligjet respektive drejt përafrimit gradual me legjislacionin e BE-së mbi mjedisin. Sfidat përfshijnë zbatimin e kufizuar, për shkak të kapaciteteve të pakëta të autoriteteve mjedisore si në nivel qendror ashtu edhe



në nivel lokal si edhe për shkak të mungesës së burimeve për monitorimin dhe sigurimin e përputhjes së plotë me standardet mjedisore.

Banka ka ndihmuar në ruajtjen e aseteve të rëndësishme natyrore dhe mjedisore të Shqipërisë dhe në nxitjen e rritjes ekonomike lokale përmes një numri projektesh, në bashkëpunim me Global Environment Facility (GEF) dhe partnerë të tjerë të zhvillimit. Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore ndihmoi në kufizimin e rreziqeve të erozionit përmes përmirësimit të menaxhimit të tokës moçalore, pyjeve dhe kullotave dhe baseve. Një projekt tjetër po përgatitet për të përmirësuar dhe promovuar vlerën e shërbimeve të ekosistemit, në partneritet me qeverinë suedeze dhe GEF. Përmes rigjenerimit të biomasës, komunitetet që varen nga pyjet morën pjesë me sukses në një program pilot, Fondi i BioKarbonit, për të reduktuar emetimin e gazrave të dëmshëm dhe marrjen e burimeve shtesë për nevojat lokale.

Projekti i Integruar i Menaxhimit të Zonës Bregdetare mbështet përmirësimin e infrastrukturës publike mjedisore dhe shërbimet bashkiake në bregdetin e jugut dhe një reduktim të rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore nga ndotja industriale. Më specifikisht, projekti mbështet infrastrukturën

mjedisore bregdetare në bashkitë e Himarës dhe Sarandës. Projekti ndihmoi gjithashtu në pastrimin e zonës së populluar prej 280 hektarësh në Porto Romano prej ndotjeve të një fabrike të vjetër kimike në jug të Durrësit që prodhonte pesticide. Për më tepër Projekti i sapo mbyllur i Menaxhimit të Integruar të Ekosistemit të liqenit të Shkodrës ndihmoi në ruajtjen dhe zgjerimin e vlerave afatgjate dhe shërbimeve mjedisore në liqenin e Shkodrës si edhe burimet e tij natyrore.

Infrastruktura urbane

Me një sërë qytetesh bregdetare përgjatë Adriatikut, qytete historike dhe destinacione trashëgimie kulturore që shfaqen në Listën e Trashëgimisë Kulturore të UNESCOs, Shqipëria është pajisur me një shumëllojshmëri vendesh të mrekullueshme dhe të veçanta për të jetuar dhe vizituar. Vite të tëra financimesh të pakëta të qytetit dhe infrastrukturës kanë grumbulluar nevoja të prapambetura investimesh në sistemin ujor dhe sanitar, manaxhimin e mbetjeve, rehabilitimin e rrugëve brenda qyteteve dhe pajisjeve urbane. Këto kanë dëmtonuar perspektivat e turizmit si edhe standardet e jetesës së qytetarëve shqiptarë.

Grupi i Bankës Botërore po mbështet infrastrukturën urbane përmes disa projekteve. Projekti i Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës (LAMP) po asiston në vëzhgimin dhe regjistrimin e rreth 400 000 pronave në zonat urbane, duke i ofruar banorëve dhe bizneseve të drejta të sigurta pronësie. Katër qytete janë mbështetur me programet e investimeve bashkiake për të përmirësuar dhe rehabilituar shërbimet themelore të infrastrukturës urbane. Projekti i miratuar së fundmi për Investimin në Sektorin e Ujit (WSIP) do të ndihmojë në përmirësimin e performancës dhe shërbimeve të nevojshme si për banorët lokalë ashtu edhe për turistët në rajonin e Dur-

rësit. Disa workshope kombëtare dhe rajonale u mbajtën në Shqipëri në vitin 2012 nën programin e Institutit të Bankës Botërore-ECA për Qytetet e Qëndrueshme. Ndërkohë, Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) vepron si këshilluese kryesore për bashkinë e Tiranës (IFC- Projekti i Tiranës për Mbetjet e Ngurta), duke prezantuar pjesëmarrjen e sektorit privat në sistemin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta për mbledhjen dhe hedhjen e mbetjeve urbane.

Transporti

Zgjerimi, përmirësimi, siguria dhe menaxhimi i rrjetit rrugor janë të gjitha shumë të rëndësishme për zhvillimin e Shqipërisë. Me mbështetjen e disa partnerëve të zhvillimit, kushtet e rrjetit rrugor janë përmirësuar. Rishikimi i parë pesëvjeçar i Planit Kombëtar Shqiptar të Transportit tregon kushtet aktuale: 67% e seksioneve primare dhe 46% e seksioneve dytësore të rrjetit kombëtar rrugor janë në gjendje të mirë ose mesatare. Ky është përmirësim domethënës krahasuar me një dekadë më parë, kur 67% e rrjetit rrugor kombëtar ishte në gjendje të keqe ose shumë të keqe. Rrugët rajonale dhe lokale janë në kushte veçanërisht të këqija dhe Shqipëria po implementon një program të konsiderueshëm investimi për të përmirësuar aksesin për komunitetet rurale. Në partneritet me disa institucione evropiane, Banka Botërore udhëhoqi një iniciativë për Projektin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale.

Çështja kyçe afatmesme është ruajtja e rrjetit dhe vijimi i forcimit të institucioneve në sektor. Fokusi në sektorin e transportit kërkon një balancë të vështirë ndërmjet zgjerimit të rrjetit rrugor aty ku është ekonomikisht e leverdisshme, ndërkohë që duhet siguruar caktimi i burimeve për të ruajtur asetet dhe vendosjen e sektorit në rrugë të qëndrueshme. Këto çështje do të adresohen përmes grantit të Zhvillimit të Kapaciteteve të



Evropës dhe Azisë Qendrore (ECAPDV), që u siguroi për të përgatitur një Projekt tëri për Ruajtjen dhe Sigurinë e Rrugëve që bazohet tek rezultatet. Objektivi i projektit të ri është ndihma për të ruajtur kushtet dhe përmirësuar sigurinë e rrjetit kombëtar rrugor për përdoruesit e rrugëve duke mbështetur qeverinë në zbatimin e Planit Kombëtar Shqiptar të Transportit, që do të prezantonte një sistem efikas për menaxhimin e aseteve rrugore dhe do të ndiqte praktika të shëndetshme për sigurinë rrugore.


Energjia

Sektori energjetik po përballet me një numër sfidash sistematike dhe gjithnjë e më të vështira që e lënë vendin vulnerabël ndaj ndërprerjeve të furnizimit dhe rritjes së mundshme të detyrimeve. Kombinimi i varësisë totale ndaj prodhimit hidrik dhe varësia nga tekat e motit, mungesa e kapaciteteve vetëgjeneruese dhe niveli i lartë i humbjeve në shpërndarje që kërkojnë importe domethënëse të energjisë, po i shton stres financiar sektorit dhe ekonomisë. Për më tepër, tarifat e shitjes me pakicë nuk reflektojnë plotësisht strukturën e kostos së sektorit, që e kombinuar me norma të ulëta mbledhjeje/apo të prapambetura të mëdha, nënkuptojnë që sektori energjetik nuk është i aftë të jetë financiarisht i qëndrueshëm. Sektori


po vuan humbje vjetore prej rreth 160-200 milion euro në humbje të shpërndarjes dhe ka pasur nevojë për import të energjisë.

Gjatë viteve 2009-2010, besueshmëria e furnizimit u përmirësua dhe nivelet e humbjes dhe borxheve të këqija në shpërndarje u reduktuan. Por gjatë 2011-2012, një kombinim i thatësirës dhe dimrit të ashpër, e reduktoi prodhimin hidrik kombëtar dhe kjo çoi në importim në përmasa të mëdha të energjisë, duke i shtuar sektorit një ngarkesë domethënëse financiare, megjithëse u ruajt siguria e furnizimit. Gjysma e parë e vitit 2013 kishte përmirësime në situatën hidrologjike, por siguria e furnizimit mbeti problematike, pasi kërkesa u rrit dhe sjelljet e motit si edhe niveli i rreshjeve variojnë nga një stinë në tjetrën, apo nga një vit në tjetrin.

SISTEMI ENERJETIK SHQIPTAR 2001-13(FURNIZIMI DHE GJENERIMI NË GWH)



PERFORMANCA E AKTIVITETIT TË SHPËRNDARJES '01-'12 (FURNIZIMI, HUMBJET DHE KONSUMI I FATURUAR NË GV)



Përmirësimi i eficiencës së sektorit të shpërndarjes mbetet sfidë kryesore. Në vitin 2008, qeveria ndërmoi një reformë të rëndësishme për sektorin energjetik, duke përfshirë veçimin e kompanisë shtetërore të energjetikës (duke ndarë kompanitë e gjenerimit, transmisionit dhe shpërndarjes), duke vendosur parimet e tregut dhe duke privatizuar shpërndarjen dhe aktivitetin e furnizimit me pakicë, me mbështetjen e Bankës Botërore dhe IFC-së, krahu i sektorit privat të Bankës. Megjithëse kjo reformë ndihmoi në racionalizimin e sektorit, fitimet në eficiencën e sektorëve të shpërndarjes (reduktimi i humbjeve dhe borxheve të këqija në 2009-2010) nuk u konsoliduan dhe nivelet e humbjeve dhe borxheve të këqija u rritën në periudhën 2011-2013, duke çuar kështu në përkeqësimin e mëtejshëm financiar të sektorit.

Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të rikthyer qëndrueshmërinë financiare dhe për t'u siguruar se humbjet, prapambetjet dhe borxhet e këqija janë zvogëluar në nivele të qëndrueshme, jo vetëm për të reduktuar presionet mbi buxhetin, por edhe për të mundësuar siguri më të madhe furnizimi.

Një sfidë tjetër është diversifikimi i burimeve të furnizimit me energji dhe reduktimi i çmueshmërisë së sektorit ndaj ndryshimeve klimatike dhe atij të motit. Shqipëria mbështetet tek energjia hidrike për të arritur gjenerimin e brendshëm të elektricitetit, që varet kështu tek tiparet rajonale të motit dhe nivelet e reshjeve. Janë ndërmarrë hapa për të reduktuar çmueshmërinë e vendit përmes: i) përfundimit të një linje ndërlidhjeje prej 400 kilovolt me Malin e Zi dhe tenderimin e një linje të ngjashme me Kosovën; ii) përmirësimeve të tjera të transmisionit të rrjetit elektrik lokal, si p.sh. përmes Projektit të mbështetur nga Banka Botërore SEE për Komunitetin e Transmisionit Energjetik, që u mbyll në vitin 2012 dhe iii) bashkë me Bankën Europiane të Investimeve dhe Bankën Europiane për Rindër-



tim dhe Zhvillim (BERZH), ndërtimin e një termocentrali (stacioni i Vlorës) i hartuar për të ofruar burime të ndryshme energjie, duke u larguar nga energjia hidrike. Ky termocentral është tashmë në procesin e rregullimit të problemeve teknike me pajisjet në breg.

Angazhimi i Bankës Botërore në sektorin energjetik, në bashkëpunim të ngushtë me IFC-në, ka përfshirë mbështetje për reformën e shpërndarjes përmes një Garancie të Pjesëshme ndaj Rreziqeve si dhe financimeve të IFC. Megjithatë, në janar 2013, Entiteti Rregullator Energjetik (ERE) i hoqi licencën CEZ Shpërndarje, sipas ligjit Energjetik, për mospërbushjen e kushteve të licencimit dhe mori kontrollin administrativ të kompanisë dhe operacioneve të saj. Një Projekt i ri i Reimëkëmbjes së Sektorit Energjetik po përgatitet me synim që të mbështesë përmirësimin e mëtejshëm në sektorin e shpërndarjes, duke financuar investime kyçe që do të bëjnë të mundur avancimin e sigurisë së furnizimit dhe do të lehtësojë reformat e mëtejshme për ta lëvizur sektorin në rrugën drejt vetëmjaftueshmërisë financiare. Grupi i Bankës Botërore po udhëheq gjithashtu një program për të forcuar sigurinë e digave në kaskadën e Drinit bashkë me BERZH, Sekretariatit Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO) dhe Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW).

IFC e ka ndihmuar qeverinë shqiptare për çështjen e privatizimit të hidrocentraleve me përmasa mesatare dhe përmes një programi këshillimor të quajtur Energjia e Rinovueshme në Ballkan, po ndihmon qeverinë në hartimin e një ligji të ri për energjinë e rinovueshme që do t'i mundësonte sektorit privat të ndërtojë centrale të realizueshme. Grupi i Bankës Botërore punon ngushtë me donatorë dhe institucione financiare nderkombëtare që janë aktive në Shqipëri.

Zhvillimi i sektorit privat

Përmirësimi i klimës së biznesit ka qenë prioritet i rëndësishëm i qeverisë. Një fushë me progres konkret është korniza ligjore dhe rregullatore për biznesin, që është modernizuar dhe riorganizuar thelbësisht. Ndër arritjet përfshihet reduktimi i konsiderueshëm i kohës (nga 36 në 5 ditë ndërmjet 2008 dhe 2012) si edhe kosto e regjistrimit të biznesit dhe tregtisë përgjatë kufijve dhe përmirësimet në rregulloret për marrjen e kredive dhe mbrojtjen e akcionerëve (indeksi i zbulimit u rrit nga 0 në vitin 2008 në 8 në vitin 2012 dhe indeksi i mbrojtjes së investitorit u rrit nga 2.7 në 2008 në 7.3 në vitin 2012. Megjithatë, mbrojtja e të drejtës së pronës, zbatimi i kontratave dhe marrja e lejes së ndërtimit janë fushtat ku Shqipëria ka performancë të dobët, jo vetëm në rajon, por edhe krahasuar me pjesën tjetër të botës.

Banka Botërore ka mbështetur zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri përmes Projektit të mbyllur të Reformës së Mjedisit të Biznesit dhe Forcimit Institucional dhe regjistrimi i të drejtës së pronësisë nën LAMP. Përveç mbështetjes dhe asistencës teknike për reformat në procesin e inspektimit, një prej pjesëve më të rëndësishme të këtij projekti ishte ndërtimi i Laboratorit Metrologjik (Ndërtimi Standard Evropian) dhe ofrimi i pajisjeve të laboratorit në mënyrë që të sigurohej rritja e numrit të shërbimeve që mund të ofrojnë ky departament për

bizneset. Ndërtesa e re e ka lejuar Komisionin Europian të vijojë mbështetjen e tij për ekspertët e metrologjisë në Shqipëri.

Aktivitetet e IFC po zgjerohen në Shqipëri. Prioritetet përfshijnë përgjigjen ndaj krizës, ndryshimet klimatike dhe përmirësimet në klimën e investimit si edhe sektorët realë. IFC gjithashtu po i fokuson shërbimet e veta të investimeve në Shqipëri tek rritja e aksesit tek financimi përmes mbështetjes së zhvillimit të institucioneve lokale financiare, veçanërisht ato që përqëndrohen tek kompanitë e vogla apo të mesme (SME). Përgjatë të gjithë sektorëve, IFC i jep prioritet investimit tek zonat më pak të zhvilluara të Shqipërisë dhe në projekte që kontribuojnë tek diversifikimi më i madh ekonomik dhe integrimi rajonal. Portofoli i investimeve të IFC në Shqipëri që prej 31 dhjetorit 2013 ka qenë 255 milion \$. Investimet më të fundit të IFC në Shqipëri përfshijnë një hua prej 6 milion euro për një pjesë prej 20% në Enso Hidro Energji për ta ndihmuar të ndërtojë një sërë projektesh të vogla hidrike, si dhe hua e investime kapitalesh në Bankers Petroleum dhe Antea Cement. IFC ka mbështetur gjithashtu Bankën Credins me një hua prej 10 milion eurosh, e rezervuar për energjinë e rinovueshme bashkë me asistencë teknike për bankat; 4 milion \$ për Union Bank, a trade finance facility dhe 30 milion euro për Kurum për blerjen dhe rehabilitimin e 4 hidrocentraleve operacionale.



IFC po mobilizon gjithashtu fonde, veçanërisht për pjesëmarrje private në infrastrukturë përmes shërbimeve të saj këshillimore. Ajo ka përdorur krahun këshillimor të transaksioneve për partneritet publik-privat për të lehtësuar financimin privat për transaksionet e partneritetit publik-privat (PPP) për privatizimin e hidroenergjisë, menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve. IFC ka ofruar mbështetjen e saj këshillimore për të përmirësuar më tej klimën e investimeve në linjë me aspiratat e përgjithshme të vendit për anëtarësim në BE. Program i klimës së investimeve i IFC-së në Shqipëri përfshin gjithashtu thjeshtëzimin e taksave, logjistikat e tregtisë dhe projekte për zgjidhjen e borxhit. Banka dhe IFC kanë punuar drejt një qasjeje të integruar për reformat në klimën e biznesit përmes aktiviteteve që promovojnë eficiencën energjetikë, energjinë e rinovueshme, thjeshtëzimin e taksave dhe lehtësimin e tregtisë përtej kufijve si edhe treguesve kyç të Të Bërjes Biznes. Projektet e IFC për eficiencën energjetike dhe energjinë e rinovueshme po kontribuojnë për këtë qëllim. IFC po ofron gjithashtu këshilla për qeverisjen e korporatave në Shqipëri.

Qeverisja dhe menaxhimi i sektorit publik

Performanca e sektorit publik është tepër e rëndësishme për ambiciet e vendit për anëtarësim në BE. Shqipëria ka bërë progress domethënës në përmirësimin e kuadrin buxhetor dhe sistemin e thesarit. Banka Botërore ka vijuar mbështetjen e saj në përmirësimin e administratës publike dhe qeverisjes, me fokus tek menaxhimi publik financiar. Analiza e Financave Publike pritet të përfundojë së shpejti. Pjesa e pare e kësaj analize u paraqit në një aktivitet publik në qershor 2014. Huaja e Zhvillimit të Politikave për Financat Publike, si dhe ajo

e Sektorit Financiar janë instrumenta të fuqishëm që kanë për qëllim sidomos të përmirësojnë qeverisjen në sektorët bankar, financiar dhe fiskal.

Në partneritet me disa donatorë, Banka po mbështet një numër programesh. Program i Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPS) është hartuar për të siguruar se politika kryesore e qeverisë së Shqipërisë dhe proceset financiare funksionojnë në mënyrë koherente, eficiente dhe të integruar. Programi *Rruga drejt Europës: Programi për Reformën e Kontabilitetit dhe Forcimit Institucional* (REPARIS) ka për qëllim ta sjellë raportimin financiar në linjë me kërkesat e BE-së. Mbështetje e mëtejshme për çështje dhe sektorë të caktuar është ofruar

përmes Facilitetit të Partneritetit Qeverisës (GPF), duke përfshirë pilotimin e suksesshëm – fillimisht në Rajonin e Europës dhe Azisë Qendrore – të sistemit të e-prokurimit të një vendi në një nga projektet e Bankës. Progres i kënaqshëm është bërë gjithashtu vitin e fundit me pjesëmarrjen e Shqipërisë në Iniciativën për Transparencën e Industrive Nxjerrëse (EITI) ku në maj 2013 Shqipëria mori akreditim nga EITI. Një grant i tretë nën Fondin e Besimit prej shumë donatorësh për EITI do të mbështesë përmbushjen e objektivave post-EITI, vecanërisht sa i përket prodhimit dhe shpërndarjes së informacionit kritik për qytetarët si edhe mbështetjen e përmirësimit të menaxhimit dhe qeverisjes në përgjithësi në industrinë nxjerrëse.

PROGRAMI I BANKËS BOTËRORE NË SHQIPËRI

Që kur Shqipëria iu bashkua Bankës Botërore në vitin 1991, shuma totale e financimit të Bankës Botërore në Shqipëri llogaritet të jetë rreth 1.8 miliard \$, duke përfshirë edhe Që kur Shqipëria iu bashkua Bankës Botërore në vitin 1991, shuma totale e financimit të Bankës Botërore në Shqipëri llogaritet të jetë rreth 1.8 miliard \$, duke përfshirë edhe Global Environment Facility si edhe fonde të tjera besimi të menaxhuara nga Banka Botërore.

Strategjia aktuale e Partneritetit të Vendit me Bankës Botërore (CPS) për 2011-2014 mbështet Strategjinë Kombëtare të Qeverisë për Zhvillim dhe Integrim duke u fokusuar në tri objektiva strategjike: (i) mbështetja e rimëkëmbjes ekonomike të Shqipërisë dhe rritja në Europën e prekur nga kriza; (ii) zgjerimi dhe mbështetja e përfitimeve sociale të Shqipërisë dhe (iii) reduktimi i cënueshmërisë nga ndryshimet klimatike dhe katastrofat natyrore. Program i CPS gjithashtu mbështet përmirësimet e qeverisë në Shqipëri dhe axhendën e integritetit në BE. Ajo fokusohet tek shpejtëmi i zbatimit të programeve aktuale, duke prezantuar në mënyrë selektive huatë e reja të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) mbi sektorë të ndryshëm, duke rritur financimin e IFC për sektorin privat në 120-150 milion \$, duke forcuar partneritetet me institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorë të tjerë, si dhe zgjerimin e programeve të dijes përmes aktiviteteve rajonale dhe kombëtare. Si pjesë e iniciativës së saj për të ndihmuar disa vende të Europës Qëndrore, Lindore dhe Juglindore, që të lehtësojnë ndikimet e krizës së eurozonës, IBRD ka rritur

zarfin e financimeve në dispozicion të Shqipërisë nën këtë Strategji, që fillimisht ishte rreth 300 milion \$ dhe tani shkon në 575 milion \$. Kjo shtesë ka shkuar kryesisht për forcimin e qëndrueshmërisë financiare, menaxhimin makroekonomik dhe rritjen. Dy hua për Politika Zhvillimore (Sektori Financiar 100 milion \$, dhe Financat Publike 120 milion \$) u aprovuan në maj 2014 nga Bordi i Drejtorëve të Bankës Botërore pasi qeveria plotësoi një sërë veprimesh në fushën e financave publike, pensione dhe energjisë. Banka ka filluar procesin e përgatitjes së Strategjisë së re, e cila paraprihet nga një Studim Diagnostikues.

Qeveria e re erdhi në pushtet në mes të shtatorit 2013 pas zgjedhjeve të qershorit. Qeveria me qasje reformuese ka ndërmarrë veprime energjike për konsolidimin fiskal, menaxhimin e financave publike, përfshirë detyrimet e prapambetura, si dhe në sistemin e pensione dhe energji. Një Njësi e Jetësimi të Prioriteteve është themeluar pranë zyrës së Kryeministrit për të ofruar vëmendje të nivelit të lartë në arritjen e rezultateve. Banka do të vijojë mbështetjen e saj, duke u bazuar tek thellimi i asistencës në fusha të angazhimit afatgjatë të Bankës në Shqipëri. Banka do të punojë ngushtë me qeverinë dhe aktorët e tjerë për të përgatitur Kuadrin e Ardhsëm të Partneritetit.

Programi Analitik dhe Këshillimor. Memorandumi Ekonomik për Shqipërinë, i titulluar Axhenda e re e Rritjes, u publikua në vitin 2010. Me mbështetjen e GPF, Banka ka

shpërndarë disa raporte në vitin 2011 mbi çështjet e qeverisjes, në lidhje me profilin e përgjithshëm qeverisës, të drejtat e pronësisë, sektorit të ujit dhe arsimit. Raporte të tjera të kohëve të fundit përfshijnë: “Vlerësimi i Menaxhimit të Borxhit” dhe “Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënia Financiare” (PEFA). Numri i fundit i Raportit të Rregullt Ekonomik (RER) për Evropën Juglindore u prezantua në dhjetor të vitit 2013 dhe Analiza e Financave Publike po përfundohet. Janë zhvilluar gjithashtu punë analitike dhe asistencë teknike, shpesh përmes programeve rajonale, mbi sektorin financiar, menaxhimin publik financiar, menaxhimin financiar publik, monitorimin e varfërisë, reformën e pensioneve, sektorin energjetik, menaxhimin urban, ujin, zbatimin e Konventës së Aarhus dhe mjedisit.


Portofoli aktual përbëhet nga 6 projekte me një total prej 286 milion \$ në kredi të Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA) dhe hua të IBRD. Portofoli është konsoliduar në mënyrë domethënëse vitet e fundit nga 18 projekte në fund të vitit fiskal (VF) 2009 në 6 projekte në VF14 me një mesatare projektësh nga 17 milion \$ në 47 milion \$. Performanca e portofolit e matur me shkallën e disbursimit është në nivele të ngjashme me vendet e tjera të rajonit, dhe pritet të jetë 21 përqind në fund të VF14. Për të përmirësuar performancën dhe rezultatet, një sërë hapash po ndërmerren në bashkëpunim me qeverinë për të unifikuar dhe thjeshtëzuar procedurat, për

ristrukturimin e projekteve me problem dhe futjen e praktikës së rishikimeve të rregullta të performancës së portofolit.

Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes (40 milion \$), Projekti i Investimeve në Sektorin e Ujit (86 milion \$), dhe dy huatë për Politika Zhvillimore (Sektori Financiar 100 milion \$, dhe Financat Publike 120 milion \$) u aprovuan gjatë VF 13 dhe VF 14. Projekti i Shërbimeve Mjedisore dhe ai i Energjisë pritet të aprovohen në VF 15.

Një portofol fondesh besimi prej 3.5 milion \$ jep një kontrit të rëndësishëm për forcimin e dialogut dhe rezultateve në fushat prioritare të CPS. Kjo reflekton gjithashtu koordinim të mirë dhe partneritet ndërmjet donatorëve. Përveç fondeve të besimit për bashkëfinancimin e projekteve, programi zgjerohet nga disa fonde të mëvetësishme, si për shembull 1.95 milion \$ fonde besimi nën program REPARIS për të përmirësuar raportimin financiar dhe një fond besimi suedez prej 2.8 milion \$ për Përmirësimin e Menaxhimit të Burimeve Natyrore. Fond i dytë i besimit prej shumë donatorësh për Sistemin e Planifikimit të Integruar (IPS-2), aktualisht rreth 4 milion \$, po jep rezultate në fushën e Menaxhimit Publik Financiar dhe do të ofrojë mbështetje për Njësinë e Delivery në zyrën e kryeminsitrit.

Banka Botërore ka ofruar grante për organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri. Në vitin 2012 një a development marketplace mbi qeverisjen e mirë promovoi ide novatore nga shoqëria civile për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënien. Qendra e Informacionit Publik e Bankës Botërore, që gjendet Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës lehtëson aksesin e studentëve, akademikëve dhe shoqërisë civile për informacion rreth çështjeve të zhvillimit dhe raportet e Bankës Botërore si edhe aktivitete në nivel global, brenda rajonit apo në Shqipëri. Ajo shërben si një qendër e rëndësishme dijeje dhe



PROJEKTET IBRD

Projekti për Modernizimin e Asistencës Sociale në Shqipëri

DATA KRYESORE

Miratuar në: 3 prill, 2012

Hyrja në fuqi: 31 tetor, 2012

Data e përfundimit: 30 qershor, 2017

FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesi	Financimi
Hua e IBRD-së	50.00
Qeveria e Shqipërisë	147.82
Kosto totale e projektit	197.82

DISBURSIMI NGA BANKA BOTËRORE NË MILIONË \$ *:

	Totali	Disbursuar	Padisbursuar
Hua e IBRD-së	50.00	8.67	41.33

* deri në qershor 2014 Shënim: Disbursimet mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit.

Objektivi i Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale në Shqipëri është mbështetja e vendit në implementimin e reformave për të përmirësuar barazinë dhe eficiencën e programeve të asistencës sociale. Projekti, që është hartuar duke u orientuar tek rezultatet përbëhet nga dy komponentë:

(1) Forcimi i implementimit dhe performancës së programeve të asistencës sociale. Objektiv i këtij komponenti është mbështetja e rezultateve nga përmirësimet në programet kryesore të asistencës sociale. Ky komponent do të mbështesë përmirësimin e implementimit si tek program i Ndhmës Ekonomike (NE) ashtu edhe përfitimet e asistencës së aftësive të kufizuara në fushat kryesore të identifikuara në hartën e gjerë të reformave: (a) parametetrat e programit (kriteret e pranueshmërisë dhe proceset e marrjes); (b) administrimi i përfitimeve proceset e biznesit, manaxhimi i informacionit, mekanizmat e pagesave dhe raportimi dhe monitorimi dhe (c) mbikqyrja dhe kontrollet.

(2) Asistencë teknike për të forcuar kapacitetet implementuese të programeve të asistencës sociale. Objektivat e këtij komponenti janë forcimi i kapaciteteve për përmirësimin e implementimit në përfitimet e ofrimit të asistencës sociale. Ky komponent do të financojë aktivitete të përzgjedhura të asistencës teknike dhe investimeve.

Rezultatet e arritura

- Trajnimi i administratorëve sociale mbi përmirësimin e kriterëve të pranueshmërisë së Ndhmës Ekonomike (do me thënë një Formulë e Unifikuar e Llogaritjes), u përfundua me sukses dhe shënon arritjen e Treguesve të parë që lidhen me disbursimet për projektin.
- Ka patur progres të konsiderueshëm gjatë muajve të fundit, me zhvillimin e fazës së parë të Sistemit Manaxhimit të Informacionit së Ndhmës Ekonomike, që pothuajse ka përfunduar (që shënon arritjen e dy Treguesve të tjerë)
- Ka filluar implementimi i reformës së Ndhmës Ekonomike mbështetur nga ky projekt
- Kanë filluar aktivitete për hartimin e reformave të asistencës së aftësive të kufizuara.

PARTNERË KYÇ: Ekipi i Bankës po bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

PARTNERË KYÇ NË ZHVILLIMIN E PROJEKTIT: Bashkimi Evropian (BE)

Programi i Menaxhimit të Integruar të Zonës Bregdetare dhe Pastrimit

DATAT KRYESORE:

Miratuar në: 29 qershor 2005
 Hyrja në fuqi: 25 nëntor 2002
 Ristrukturuar: 22 mars 2010
 Data e përfundimit: 31 mars 2015

DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE NË MILION \$ *:

	Totali	Disbursuar	Padisbursuar
Kredi e IDA-s	17.50	12.10	5.40

FINANCIMI NË MILION \$

Financuesi	Financimi
IDA Credit	18.05
Kredi e IDA-s	5.71
Qervia e Shqipërisë	3.11(closed)
Donatorë të tjerë (Qeveria Holandeze)	2.23
Donatorë të tjerë (Qeveria Japoneze)	2.60
Donatorë të tjerë (Qeveria Austriake)	1.8 (closed)
Donatorë të tjerë (KE)	0.95(closed)
Donatorë të tjerë (GEF)	
Kosto totale e projektit	34.45

* deri në qershor 2014 - Shënim: Shumat e disbursuara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit.

Në vitin 2002, Shqipëria ndërmorri një iniciativë për manaxhimin e integruar të zonës bregdetare, me qëllim mbrojtjen e kësaj zone për brezat e sotëm dhe të ardhshëm si dhe adoptoi zyrtarisht rekomandimet kryesore të Konventës së Barcelonës për Mbrojtjen e Detit të Mesdheut. Projekti për Manaxhimin e Integruar të Zonës Bregdetare dhe Pastrimit luan një rol katalitik për mobilizimin e asistencës së zhvillimit dhe përmirësimin e kushteve mjedisore dhe sanitare, të cilat janë thelbësore për zhvillimin afatgjatë të bregdetit dhe turizmit. Objektivi i zhvillimit të projektit është të asistojë qeverinë shqiptare për të zhvilluar, mbi baza të qëndrueshme, turizmin në bregdetin e Shqipërisë së jugut duke përmirësuar infrastrukturën kryesore publike mjedisore dhe shërbimet lokale, rregulluar dhe ndaluar problemet me ndotjen që vjen nga një ish-fabrikë kimike në Porto Romano afër Durrësit, si dhe duke përmirësuar infrastrukturën komunitare dhe rritur burimet arkitekturore dhe kulturore. Projekti u ristrukturua në vitin 2010 dhe në 2012.

Rezultatet e arritura:

- Në korrik të vitit 2008 u miratura Plani dhe Rregullorja për Zhvillimin e Bregdetit Jugor. Pastrimi i pikës së nxehtë në Porto Romano u përfundua në vitin 2011, me një zonë prej 280 hektarësh të pastruar dhe më tepër se 45 000 metër kub mbetjesh të rrezikshme të asgjësuar dhe mbledhura, duke mbrojtur kështu popullsinë e Porto Romanos nga rreziqet mbi shëndetin.
- Faza e parë e programit të Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Fshatit Bregdetar (CVCD) përfunduar në vitin 2010, mbështeti investimin tek infrastruktura e fshatit në tre bashki bregdetare dhe 12 fshatra bregdetarë, që përfshinte: një sistem të ri furnizimi me ujë që i shërben më tepër se 400 familjeve në Gjilek; rehabilitimin e sistemit të



furnizimit më ujë për 167 familje në Vuno; furnizimin me ujë për 315 familje në Piqeras; një rrugë prej 1.3 km në Orikum, për turistët ditorë dhe banorët; rehabilitimin e një rruge prej 1.2 km që i shërben 132 familjeve dhe turistëve në Dhërmi; përmirësimin e një rruge panoramike prej 2.6 km në Manastirin e Shën Theodorit me një peizazh të Kanionit të Gjipesë dhe një rrugë këmbësorësh prej 0.6 km në kështjellën e Borshit për vizitorët dhe pelegrinët.

- Faza e dytë e programit CVCD është përfunduar në masën 70% me skema për furnizimin me ujë të 5 fshatrave dhe 8 projekte për rehabilitimin e rrugëve të fshatrave në Ilias, Nivicë, Piqeras, Ksamil, Plakë-Qenuro, Xarra, Palavli, Bajkaj, Palasa, Lukova dhe Qeparo.
- Landfilli Bajkaj-Palavli po ndërtohet, me rreth 40% të punimeve të përfunduara. Do të ofrojë shërbime të mbetjeve të ngurta në bashkitë e

Himarës dhe Sarandës.

- 95% e punimeve rehabilituese për Saranda Gateway Passenger Terminal është përfunduar, që do të përmirësojë kapacitetin e portit të pasagjerëve të pranojë anije më të mëdha turistike dhe është përfunduar gjithashtu zhvillimi i infrastrukturës së sipërfaqes të portit.

PARTNERË KYÇ: Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, e cila është përgjegjëse për koordinim e përgjithshëm të projektit dhe manaxhimin; Ministria e mjedisit, që është përgjegjëse për pastrimin e pikës së nxehtë të rrezikshme pranë Durrësit; Distrikti Bregdetar dhe administrata bashkiake, këshillat e fshatrave në komunitetet bregdetare dhe organizat lokale jo qeveritare (OJQ).

PARTNERË KYÇ NË ZHVILLIMIN E PROJEKTIT përfshijnë Qeverinë e Holandës, Austrisë dhe Japonisë, Komisionin Evropian dhe Fondin për Mjedisin Global.

Projekti për Administrimin dhe Menaxhimin e Tokës

DATAT KRYESORE

Miratuar në: 22 shkurt 2007
 Hyrja në fuqi: 23 korrik 2007
 Ristrukturuar: 21 janar 2011
 Data e përfundimit: 30 qershor 2014

FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesi	Financimi
Kredi e IDA-s	15.00
Huatë e IBRD-së	19.96
Qeveria e Shqipërisë	6.00
Bashkitë e Shqipërisë	9.00
SIDA	4.50
PHRD	1.54
Kosto totale e projektit	56.00

DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE NË MILION \$ *:

	Totali	Disbursuar	Padisbursuar
Kredi e IDA-s	15.00	14.17	0.83
Hua e IBRD-së	19.96	10.01	9.95

* deri në qershor 2014 - Shënim: Shumat e disbursuara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit.

Të drejtat e sigurta të pronësisë, bashkë me një regjim transparent të manaxhimit të tokës janë thelbësore për krijimin e një tregu funksional toke dhe pronësie në çdo vend. Këto në këmbim krijojnë incentiva për bizneset lokale dhe ndërkombëtare, për ekonomitë familjare dhe individët që të investojnë në toka dhe pronësi. Regjistrimi i saktë dhe të drejtat e pronësisë përbëjnë kushte sine qua non për decentralizimin fiskal dhe autonominë bashkiake që rrjedh nga të ardhurat prej taksave të pronës. Ky projekt ka si qëllim të lidhë sistemin e reformave të tokës dhe pronës me planifikimin e përforcuar urban dhe investimet bashkiake. Sëbashku, këto masa kanë si qëllim të përmirësojnë perspektivën për zhvillim lokal. Për më tepër, me përmbytyet më të fundit në Prefekturën e Shkodrës dhe të Lezhës, disa financime projektsh lokale janë rishpërndarë për të bërë të mundur rikonstruktimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës mbrojtëse ndaj përmbytyjeve dhe sistemin e furnizimit me ujë.

Objektivat e zhvillimit të projektit: Objektivat e projektit janë të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e admin-

istrimit dhe manaxhimit të tokës përmes rritjes së sigurisë së pronësisë dhe përmirësimit të planifikimit urban. Gjithashtu, përmes rindërtimit të aseteve fizike dhe restaurimit të shërbi-meve esenciale në zonat e prekura nga përmbytyet, në prefekturat e Shkodrës dhe Lezhës.

Rezultatet e arritura

Komponenti A (Siguria e zotërimit dhe të drejtat e regjistrimit të pronës së patundshme)

Gjatë dy viteve të fundit, Komponenti A i projektit ka arritur disa suksese të rëndësishme:

- a. Është miratuar një strategji ndërsektorale për mbrojtjen e të drejtës së pronës që mbulon të gjitha aspektet e administrimit dhe manaxhimit të tokës. Kjo strategji ofron një model për zgjidhjen e çështjeve me të cilat përballet manaxhimi dhe administrimi i tokës në Shqipëri dhe formon bazën për diskutimet me Bashkimin Europian (BE) rreth kriterëve të



anëtarësimi për këtë sektor në veçanti.

b. Ka kaluar një ligj i ri për të drejtën e regjistrimit të pronës dhe Zyrat e Regjistrimit të Pronës së Paluajtshme janë bërë agjenci autonome dhe vetë-financuese nën drejtimin e bordit menaxhues që prej prillit të vitit 2013.

c. Noterive u është ofruar akses online te të dhënat e regjistrimeve në Tiranë, Durrës dhe 5 qytete të tjera të mëdha, duke i bërë transaksionet më transparente, më të shpejta, më të lira dhe më të besueshme.

d. Sistemi i informimit i zhvilluar nën këtë projekt u bazua tek një model të dhënash zhvilluar përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të cilit i është dhënë akreditimi nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO). Kur ky sistem të përfundojë dhe regjistrimi ka mbaruar, do të jetë baza për një prej sistemeve të para online në një fushë kryesore nën strategjinë e qeverisë për e-qeverisjen. Aktivitetet e Komponentit B dhe Komponentit C janë kryer me sukses dhe të gjitha rezultatet

e targetuara janë përmbushur. Komponenti D (Përgjigja Emergjente). Progresi për këtë komponent ka qenë i variueshëm: (i) punimet civile lidhur me koleksionuesin e ri të ujit të stuhive në qytetin e Shkodrës janë përfunduar; (ii) rehabilitimi i Stacioneve të Furnizimit me Ujë në Bahcallëk dhe Dobrac kanë përfunduar; (iii) Stacioni i Pompimit dhe Kullimit në Velipojë ka përfunduar dhe ai i Tales do të përfundojë në maj 2014, por punimet e CAS do të vijojnë edhe pas mbylljes së projektit dhe (iv) Stacioni i Furnizimit me ujë në Trush është shtyrë deri sa një plan veprimi i rivendosjes të jetë gati.

PARTNERË KYÇ SHQIPTARË: Ministria e Drejtësisë dhe IPRO, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave dhe Bordet e-ujtjes dhe bashkitë e përzgjedhura.

PARTNERË KYÇ NË ZHVILLIMIN E PROJEKTIT: SIDA; Qeveria e Japonisë përmes PHRD; USAID, Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës.

Komuniteti Energjistik i Evropës Juglindore

APL5 - Projekti për Sigurinë e Digave

DATAT KRYESORE

Miratuar në: 30 qershor 2008
 Hyrja në fuqi: 16 dhjetor 2008
 Data e përfundimit: 31 dhjetor 2016

DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE NË MILLION \$*:

	Totali	Disbursuar	Padisbursuar
Kredi e IDA-s	32.87	14.43	20.87
Hua e IBRD-së	20.50	0.25	21.35

FINANCIMI NË MILLION \$*:

Financuesi	Financimi
Kredi e IDA-s	35.30
Hua e IBRD	21.60
KESH	8.70
Donatorë të tjerë (SECO)	7.40
Donatorë të tjerë (BERZh)	16.50
Donatorë të tjerë (KfW)	20.50
Kosto totale e projektit	110.00

* deri në qershor 2014 - Shënim: Shumat e disbursuara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit.

Diga e fundit e hidrocentralit në Shqipëri u ndërtua në mesin e viteve 80'. Këto facilitete infrastrukturore kryesore nuk janë monitoruar në mënyrën e duhur dhe janë mirëmbajtur dobët për mëse 15 vjet dhe tashmë rrezikohet infrastruktura e tyre. Duke ndjekur alarmin e dhënë nga Banka Botërore për këtë çështje, një "Pyetësor për sigurinë e digave të hidrocentraleve mbi kaskadat e Drinit dhe Matit" u përgatit, financuar nga Sekretariati Zviceran i Punëve Ekonomike (SECO). Studimi u përfundua në fund të vitit 2006. Raporti identifikoi mungesa serioze dhe arriti në përfundimin se "gjendja aktuale e digave është e pasigurtë dhe se katastrofa mund të konsiderohet e mundshme nëse çështja lihet që të përkeqësohet më tej". Mëshjetja për hidrocentralet e Shqipërisë do të përmirësonte gjithashtu edhe fuqinë hidrike në tërësi të vendit si dhe do të bënte që të përfitonte i gjithë sistemi rajonal elektrik. Më e rëndësishmja për tregun rajonal të energjisë është kapaciteti i konsiderueshëm grumbullues i digave, i cili mund të pro-

movojë efikasitetin ekonomik në tregun rajonal. Objektivi i zhvillimit të projektit është zhvillimi i një tregu rajonal funksional në Evropën juglindore dhe integrimi i tij në tregun e brendshëm të energjisë të Bashkimit Evropian nëpërmjet zbatimit të investimeve prioritare që mbështet tregun energjistik dhe veprimet e sistemit të shpërndarjes në prodhimin e energjisë elektrike. Projekti do të kontribuojë në sigurimin e digave kryesore energjetike të Shqipërisë dhe do të përmirësojë efikasitetin e tyre operacional si dhe do të shtojë stabilitetin e furnizimit me energji për tregun rajonal të energjisë. Projekti do të asistojë Shqipërinë në maksimizimin e përfitimeve nga hidrocentralet ekzistues, duke përmirësuar praktikën operacionale dhe të faciliteteve ekzistuese dhe duke mundësuar pjesëmarrje më aktive në tregun rajonal të energjisë. Projekti gjithashtu do të promovojë investimet e sektorit privat në hidrocentralet duke mbledhur, organizuar dhe mundësuar më shumë të dhëna dhe studime të potencialeve hidroenergjetike të vendit.



Rezultatet e arritura

Projekti ka arritur disa rezultate të ndërmjetme:

- Studimi i dizenjimit të punëve riparuese në Projektin e Sigurisë së Digave është finalizuar (i ndërmarrë nga Konsulentë dhe i financuar nga SECO Zviceran).
- Paneli i Ekspertëve për Sigurinë e Digave është zgjedhur dhe është aktiv që prej 2009-ës.
- Një vlerësim i punimeve rehabilituese në kaskadën e Drinit dhe në hidrocentralet e saj në kuadër të përmbytjeve gjatë fillimit dhe fundit të vitit 2010 kanë shtruar nevojën urgjente për të shtrirë këto përpjekjeve dhe për të mundësuar investime shtesë për të rritur impaktin e projektit dhe për të arritur objektivat e zhvillimit.
- Financimi Shtesë është miratuar dhe zbatimi i punimeve të mëdha rehabilituese dhe civile ka filluar.
- Studimi për Përmbytjet në Kaskadën e Hidrocentralit të Lumit të Drinit u prezantua dhe bazuar tek ky studim do të ndërmerret

përgatitja e një studimi për realizueshmërinë, hartimi i dokumentave përkatëse për Sigurimin e Manaxhimit të Mbrojtjes nga Përmbytjet dhe Kapacitetet e reja të Shkarkimit.

- Forcimi i Sigurisë së Digave, Implementimi i Metodologjisë së Studimit të Rrezikut dhe Përgatitja e një Plani për Përgatitjen në rast Emergjencash janë ende në fazën përgatitore.
- Puna rehabilituese për hidrocentralin e Komanit ka nisur në korrik 2013. Ndërkohë po përgatitet Raporti i Vlerësimit të Ofertave për paketën e rehabilitimit të Sistemeve të Shkarkimit.
- Dizajni dhe dokumentat e ofertës për Komani Dam Toe dhe rehabilitimi i zonës së gërryer janë aprovuar dhe punimet po financohen nga BERZH.

PARTNERË KYÇ: Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), agjencia implementuese e projektit.

PARTNERË KYÇ NË ZHVILLIMIN E PROJEKTIT përfshijnë SECO Zicerane, BERZh dhe KfW.

Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes në Shqipëri

DATAT KRYESORE

Miratuar në: 29 nëntor 2012
 Hyrja në fuqi: 13 maj 2013
 Data e përfundimit: 31 maj 2018

FINANCIMI NË MILLION \$:

Financuesi	Financimi
Hua e IBRD	40.00
Qeveria Suedeze	5.00
Kosto totale e projektit	45.00

DISBRUSIMET E BANKËS BOTËRORE, MILLION \$*:

	Totali	Disbursuar	Padisbursuar
Hua e IBRD-së	40.0	1.68	38.32
TF Suedeze	5.00	0.27	4.40

* deri në qershor 2014 - Shënim: Shumat e disbursuara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit

Objektivat e Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes janë (i) vendosja e një kornize strategjike për të manaxhuar burimet ujore në nivel kombëtar dhe në bazenat e lumit Drini-Buna dhe Seman dhe (ii) përmirësimi në mënyrë të qëndrueshme, i performancës së sistemeve të ujitjes në zonën e projektit.

Projekti ka katër komponentë: 1) Komponenti i rehabilitimit të sistemeve të digave, ujitjes dhe kullimit (I&D) do të rehabilitojnë dhe modernizojnë sistemet I&D dhe infrastrukturën e digave. 2) Mbështetja institucionale për komponentin I&D do të përmirësojë performancën e organizatave që ofrojnë shërbime ujitjeje. Këto përfshijnë implementimin e reformave institucionale dhe forcimin e kapaciteteve të qeverive lokale, bordeve të kullimit dhe Shoqatat e Përdoruesve të Ujit dhe do të pilotojë partneritete publike-private në shërbimin e dorëzimit të I&D përmes rekrutimit të operatorëve të tretë për të ofruar shërbime ujitjeje në tre skema pilote I&D. 3) Komponenti i Manaxhimit të Integruar Ujor do të themelojë një kornizë strategjike për të manaxhuar burimet ujore në nivel kombëtar dhe në nivelin e bazeneve të Drinit-Bunës dhe Semanit. 4) Komponenti i Mbështetjes së Implementimit do të manaxhojë burimet e projekteve në përputhje me objektivat dhe procedurat e projektit.

Rezultatet e arritura

Projekti po implementohet nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave (MBZHRAU) dhe Ministria e Mjedisit (MM). Ekipe të projektit në të dy ministritë kanë organizuar një sërë aktivitetesh, duke përfshirë:

- Procesin e përzgjedhjes për studimet e realizueshmërisë dhe hartime të detajuara për investimet për ujitje dhe kullim dhe mbikqyrja e punimeve të tilla si dhe rehabilitimi i digave në MBRZHAU dhe për përgatitjen e një strategjie të integruar të ujit dhe planet e manaxhimit të bazeneve lumore;
- Përgatitjen e databazës së burimeve ujore dhe rehabilitimit të Agjencive të Baseneve Lumore në MM.

PARTNERË KYÇ: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave dhe Ministria e Mjedisit janë përgjegjëse për koordinimin dhe manaxhimin e përgjithshëm të projektit, partnerë të tjerë përfshijnë bordet e kullimit, qeveritë lokale dhe agjencitë dhe këshillat e bazeneve lumore.

PARTNERI KYÇ NË ZHVILLIMIN E PROJEKTIT: Qeveria suedeze.



Garancia e Riskut të Pjesshëm (PRG) për Privatizimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë në Shqipëri

DATAT KRYESORE

Miraturar në: 5 maj 2009
Hyrja në fuqi: 15 maj 2009
Data e përfundimit: 31 maj 2017

FINANCIAR PREJ GJITHË BASHKËFINANCUESVE, MILION \$:

Financuesi	Financimi
Hua të IBRD	78.00
Kosto totale e projektit	78.00

DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE NË MILLION \$:

	Totali	Disbursuar	Padisbursuar
Hua e IBRD-së	78.00	0.00	78.00

* deri në qershor 2014 - Shënim: Shumat e disbursuara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit.

Për të mbajtur nën fre përdorimin e paligjshëm të elektricitetit dhe mospagimin e faturave, qeveria vendosi në vitin 2008 të privatizojë kompaninë shpërndarëse duke shitur 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Disa investitorë potencialë shprehën në atë kohë shqetësime rreth rreziqeve rregullatore që lidheshin me privatizimin e OSSH; Korporatën Ndërkombëtare Financiare (IFC), këshillues i transaksionit, rekomandoi në atë kohë që qeveria t'i kërkonte instrumentin e Bankës Botërore për Garancinë e Pjesshme të Riskut (PRG) për të ndihmuar në lehtësimin e transaksionit. Në vitin 2009 CEZ a.s., një investitor çek, bleu 76% të aksioneve me një vlerë prej 102 milion eurosh, me balancën e aksioneve të ruajtur nga qeveria.

Objektivi i zhvillimit të projektit të Garancisë së Riskut të Pjesshëm është lehtësimi i privatizimit të OSSH-së dhe Furnizuesit me Pakicë në kontekstin e një kornize të re dhe të patestuar rregullatore, që është vendosur në korrik të vi-

tit 2008, vetëm pak muaj para privatizimit dhe në mungesë të një baze të dhënash rregullatore me OSSH private dhe strukturën aktuale të tregut. Rezultatet: indikatorët e rezultateve afatmesme të projektit janë: (i) investime paraprake kapitali janë bërë nga investitori për blerjen e aksioneve nga qeveria dhe (ii) funksionimi i OSSH-së dhe FP-së janë në përputhje me detyrimet e parashikuara në licencën e tyre dhe me zbatimin e programeve të investimit aprovuar nga Entiteti Rregullator i Energjisë (ERE). Indikatorët kryesorë për rezultatet janë: (i) reduktimi në humbjet e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe (ii) përmirësimi i mbledhjes në përputhje me parametrat e vendosur në Kornizën Rregullatore.

PARTNERË KYÇ: Ministria e Financave, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Operatori Shqiptar i Sistemit të Shpërndarjes (CEZ Shpërndarje); Autoriteti Shqiptar Rregullues i Energjitikës dhe KESH dhe OST.



Rezultatet e arritura

- Fillimisht, u përmirësua situata e furnizimit me energji elektrike në Sistemin e Shpërndarjes dhe Furnizimit me Pakicë dhe besueshmëria e furnizimit. Furnizimi neto në Shqipëri u rrit me 5% çdo vit në periudhën 2009-2013 dhe arriti një total prej 960 gigavat orësh në vitin 2013, rritur prej 6630 GWh në vitin 2009; sasia e importeve ishte 3200 GWh (197 milion euro), GWh, 2540 GWh (161 milion euro) dhe 1390 GWh (72 milion euro) respektivisht në 2011, 2012 dhe 2013.
- Megjithatë, rezultatet (nivelet e humbjes në shpërndarje dhe borxhet e këqija) e kanë përkeqësuar situatën në mënyrë të konsiderueshme gjatë tre viteve të fundit, pas përkeqësimit të situatës financiare për aktivitetin e shpërndarjes dhe për gjithë sektorin energjetik. Humbjet ishin 2440 GWh (148 milion euro), 3081 (196 milion euro) dhe 3218 GWh (142 milion euro), respektivisht në 2011, 2012 dhe 2013.
- Tarifat e shitjes me shumicë dhe pakicë u aprovuan për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014.
- Në janar 2013, ERE hoqi licencën e CEZ sh.a, sipas Ligjit mbi Energjinë, për mospërmbushje të kushteve të licencës së tij dhe mori kontroll administrativ dhe të operacioneve të saj.
- Të dyja palët, qeveria e Shqipërisë dhe CEZ, pretendojnë një shkelje të Marrëveshjes për Blerjen e Aksioneve dhe Deklaratës Rregullatore; por asnjë gjë nuk është vendosur ende për PRG dhe të dyja palët po përpiqen të arrijnë një marrëveshje miqësore
- Privatizimi i shpërndarjes nuk ka dhënë rezultatet e pritura sa i përket përmirësimit të shërbimeve të shpërndarjes; përpjekje të mëtejshme nevojiten për të kthyer realizueshmërinë financiare të këtij sektori, jo vetëm për të reduktuar presionet mbi buxhet, por edhe për të rritur sigurinë e furnizimit dhe maksimizimin e manaxhimit të të ardhurave, duke i mundësuar bankës të ndërhyjë për të ndihmuar sektorin.

Projekti i Investimit në Sektorin e Ujit

DATAT KRYESORE

Miratuar në: Dhjetor 20, 2013
 Hyrja në fuqi: 13 Maj 2013
 Data e përfundimit: 30 Qershor 2019

FINANCIMI NË MILLION \$:

Financuesi	Financimi
Hua e IBRD-së	85.3
Kosto totale e Projektit	85.3

DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE, MILLION \$*:

	Totali	Disbursuar	Padisbursuar
Hua e IBRD-së	85.3	0.21	85.09

* deri në qershor 2014 - Shënim: Shumat e disbursuara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit.

Objektivi është të: (i) përmirësohet cilësia e shërbimeve ujore dhe mbetjeve ujore në Zonën e Durrësit dhe (ii) përmirësimi i performancës financiare të Ujësllësit të Durrësit. Komponentët e projektit janë:

- i. Investimet Prioritare në Furnizimin me ujë do të financojnë 6 puse të prodhimit të furnizimit me ujë dhe një tubacion për transmetimin e furnizimit me ujë do të ofrojë deri në 6301 l/s kapacitet shtesë furnizimi në Durrës; investime ndihmëse, duke përfshirë rezervuarët e ngritur që lidhin bashkitë/komunitetet brenda zonës së Durrësit bashkë me rrugën e tubacionit të transmissioinit tek sistemi i furnizimit me ujë dhe investimet prioritare në rrjetin e shpërndarjes së ujit në Durrës, duke përfshirë masa për pajisjen që zbulon rrjedhjen e ujit dhe valvula për reduktimin e presionit më mënyrë që të reduktohen humbjet.
- ii. Investimet në Rrjetin e Ujërave të Zeza do të financojnë investime prioritare në këtë fushë, duke përfshirë rehabilitimin e pjesëve kritike të sistemit ekzistues të kanalizimeve në qytetin e Durrësit; ndërtimin e rrjetit dytësor dhe tretësor të kanalizimeve në zonën e plazhit të Durrësit; furnizimin e pajisjes me fuqi të lartë për pastrimin e kanaleve për Ujësllësin e Durrësit dhe forcimin e aftësisë paraprake të Ujësllësit të Durrësit për të operuar dhe ruajtur një central të ri trajtimi të ujërave të zeza.

- iii. Programi i Zhvillimit Institucional, Forcimi i Utilitetit dhe Manaxhimi i Kërkesës për Ujë do të mbështesë politikën e gjerë të qeverisë dhe do të reformojë axhendën në nivel kombëtar me ndërhyrje specifike në nivel lokal. Investimet përfshijnë hartimin dhe implementimin e Programit të Manaxhimit të Kërkesës për Ujë; mbështetje për Njësinë e Monitorimit dhe Standardizimit të Performancës; përgatitjen dhe implementimin e një Plani për Përmirësimin e Performancës dhe mbështetje tjetër për Forcimin Institucional të Ujësllësit të Durrësit; Analizë Teknike dhe Ndërtim Kapacitetesh në veçanti sa i përket eficiencës energjetike dhe një auditim vjetor për Ujësllësin e Durrësit.
- iv. Mbështetja për Implementimin e Projektit do të ndihmojë në implementimin e projektit, duke përfshirë pagat për stafin e njësive së implementimit të projektit (PIU), kostot e operimit të PIU, parashikimet për pajisjet e nevojshme, shërbimet këshilluese që mbështesin rishikimet teknike të investimit të projektit, si edhe mbikqyrja, moniorimi, vlerësimi dhe raportimi i përgjithshëm i projektit.

PARTNERË KYÇ: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturas dhe Ujësllësi i Durrësit janë partnerët kryesorë.

Rezultatet e arritura:

Projekti është në fazën fillestare të implementimit.



Projekti i Menaxhimit të Përmirësuar të Burimeve Natyrore në Shqipëri

DATA KRYESORE

Miratuar në: 3 prill 2012
 Hyrja në fuqi: 31 maj 2012
 Data e përfundimit: 30 qershor 2014

FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesi	Financimi
Qeveria suedeze përfaqësuar nga Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar	2.7

DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE NË MILLION \$ *:

	Totali	Disbursuar	Padisbursuar
Granti	2.7	2.31	0.40

* deri në qershor 2014 - Shënim: Shumat e disbursuara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit..

Objekti i këtij projekti është: (i) të sigurojë mbështetje të vazhdueshme për manaxhimin e burimeve natyrore duke u bazuar tek komuniteti, veçanërisht në tokat malore që janë shpesh pre e erozionit. Kjo do të bëhet përmes planifikimit dhe investimeve pjesëmarrëse dhe (ii) të përgatisë një Projekt për Shërbimin Mjedisor. Ky projekt do të:

- i. Mbështesë përgatitjet në vijim të planeve pjesëmarrëse në manaxhimin e pyjeve dhe kullotave si edhe plane për ujëmbledhës të vegjël, siç është mbështetur tashmë nga Projekti për Zhvillimin e Burimeve Natyrore (PZhBN), financuar nga Banka dhe qeveria suedeze.
- ii. Mbështesë zbatimin e punimeve në pyje dhe kullota, sekuestrimin e karbonit dhe ujëmbledhësitë vegjël, siç tashmë mbështetet nga PZhBN.
- iii. Mbështesë përgatitjen e Projektit të propozuar të Shërbimit Mjedisor dhe
- iv. Pilotojë skema konkurruese grantesh për manaxhimin e ujëmbledhësve për të mbështetur masat e targetuara dhe fushat për masat agro-mjedisore si edhe qasje të bazuara tek komuniteti në agro-mjedis.

Rezultatet e arritura:

Të gjitha aktivitetet e grantit janë nën implementim të plotë

- Punimet e pyllëzimit në sekuestrimin e karbonit janë përfunduar dhe planifikuar në të gjithë fushat e parashikuara
- Rishikimi i Shpenzimeve Publike Mjedisore, Rishikimi Operacional, Auditimi Mjedisor Vjetor i Projektit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore dhe Vlerësimi Socio-Ekonomik është përfunduar.
- Përgatitja e PSHM do të finalizohet në qershor 2014
- Në 23 qershor 2013 128 757 reduktime të çertifikuara të emetimeve u lëshua për Projektin e Rigjenerimit Natyror të Asistuar nga Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike, që shënon një moment të rëndësishëm për projektin e sekuestrimit të karbonit dhe përfituesit e tij.

PARTNERË KYÇ: Banka Botërore po vepron si administrator i fondeve të grantit të qeverisë suedeze. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave ka përgjegjësinë e përgjithshme për projektin dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave është përgjegjëse për zbatimin përmes ekipit të vet të manaxhimit të projektit.



Shqipëria: Fondi i Besimit Shumëdonatorësh për Sistemin e Planifikimit të Integruar (IPS2)

DATAT KRYESORE

Miratuar në: dhjetor 2012
 Hyrja në fuqi: mars 2013
 Data e përfundimit: mars 2016

FINANCIMI NË MILION \$

Financuesi	Financimi
Kredi e IDA-s	3.7
Donatorë të tjerë	
Kosto totale e projektit	3.7

DISBURSIMET E BANKËS BOTËRORE, MILLION \$*

	Totali	Disbursuar	Padisbursuar
Granti	3.7	2.31	0.40

* deri në qershor 2014 - Shënim: Shumat e disbursuara mund të kenë ndryshime nga financimet për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit në kohën e disbursimit.

Projekti synon të adresojë dobësinë në anën e monitorimit duke vendosur një zinxhir koherent rezultatesh ndërmjet rezultateve të programeve të buxhetit dhe treguesve të nivelit të lartë (për shembull treguesit e impaktit në nivelin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim), përmes zhvillimit të rezultateve të ndërmjetme në nivel politikash apo strategjish, që deri tani kanë qenë një lidhje e munguar. Komponenti i tretë gjithashtu pritet të mbështesë integrimin e manaxhimit financiar dhe proceseve të politikave publike. Kjo do të lehtësohet përmes Sistemit të Integruar Shqiptar të Informacionit për Manaxhimin Financiar (AFMIS), që do të lidhë Planin Afatmesëm të Buxhetimit me thesarin, duke mundësuar kështu gjetjen e rregullt të rezultateve në nivel programi dhe lidhjen e tyre me inputet buxhetore, ndërkohë që Sistemi i Informacionit të Sistemit të Integruar të Planifikimit (IPSIS) do të lehtësojë monitorimin e rezultateve në nivel programi si edhe implementimin e politikave dhe rezultatet e ndërmjetme në nivel strategjik.

Projekti do të kontribuojë në forcimin e manaxhimit publik financiar dhe makroekonomik, që është një prej prioriteteve kryesore të Strategjisë së Partneritetit të Bankës Botërore.

1. Objektivi i propozuar i zhvillimit i IPS 2 është të “Forcojë implementimin e IPS, duke krijuar kushtet për prezantimin e orientimit tek performanca në planifikimin e politikave dhe proceseve buxhetore dhe duke përmirësuar kapacitetet institucionale për të monitoruar rezultatet në nivel strategjie dhe programi”.
2. Orientimi kah performancës është një lidhje thelbësore ndërmjet strategjive dhe politikave (SKZHI dhe strategjitë mbështetëse sektoriale/ndërsektoriale), nga njëra anë dhe proceset buxhetore nga ana tjetër. Në këtë kontekst, performanca kuptohet gjerësisht, duke përfshirë masa të efikasitetit teknike (efikasiteti i kostos) si edhe rezultate dhe outpute programi.

Rezultatet e arritura

Projekti ka filluar kohët e fundit dhe nuk janë prodhuar ende rezultate konkrete. Disa prej aktiviteteve janë prokuruar, duke përfshirë aktivitete trajnimi dhe një vlerësim të AMFIS dhe Sistemin e Informimit për Manaxhimin e Asistencës së Jashtme. Projekti do të mbështesë themelimin e Njësisë së Ofrimit, një prej prioriteteve të qeverisë së re.

PARTNERË KYÇ: Ministria e Financave; Departamenti i Koordinimit të Donatorëve dhe Strategjive; Këshilli i Ministrave. Departamenti i Administrës Publike; Agjencia Kombëtare për Shoqëinë e Informacionit dhe ministritë e tjera të linjës.

PARTNERËT KRYESORË në zhvillimin e projektit: SIDA, Agjencia Austriake e Zhvillimit (ADA); Agjencia Zicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC); BE (që do t'i bashkohet Fondit të Besimit gjatë 2014).

PROJEKTET IFC

Projekti i Eficiencës së Energjisë për Banesat

DATAT KRYESORE

Miraturar në: janar 2009

Data e përfundimit: Dhjetor 2015

FINANCIMI NË MILION \$

Financuesi	Financimi
Kontributi i IFC-së	0.76
Kosto totale e projektit	0.76

Ky projekt do të sigurojë mbështetje për institucionet financiare për të zgjeruar huatë e vogla dhe për të siguruar efikasitet energjetik, ulje të konsumit energjetik dhe përmirësime në komoditet. Për më tepër, objektivi është të punohet ngushtë me Shërbimet e Investimeve për të rritur impaktin e projektit. Ai përbëhet prej tri komponentësh:

(i) Ndërgjegjësimi Publik: disa aktivitete do të ndërmerren në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi publik mbi efikasitetin energjetik dhe kursimet në energji; (ii) Shërbime Këshilluese për Institucione Partnere Financiare. Ky komponent është për të mbështetur institucionet partnere financiare të ndërtojnë një produkt të ri të efikasitetit energjetik dhe për ta drejtuar tek tregu i përshtatshëm i targetuar si edhe (iii) Kornizë rregulatore për të mbështetur Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) në rishikimin e draft ligjit për efikasitetin energjetik dhe në zhvillimin e akteve nënligjore përkatëse.

Rezultatet e arritura

- Projekti po punon me katër institucione financiare – Banka Credins, Banka Societe Generale, Fondi BESA (një institucion mikrofinanciar (mfi) dhe NOA (mfi) – për të prezantuar hua të vogla që kanë për qëllim përmirësimet në eficiencën energjetike. Në dhjetor 2013, projekti ka disbursuar mbi 2 800 hua për eficiencën energjetike në shumën 10.8 milionë \$, duke çuar kështu në mesatarisht 10 000 megavat kursime energjie dhe deri në 11 000 (ton/vit)

emetim gazi të dëmshëm është shmangur. Asistenca teknike për Bankën Credins ka çuar në një investim të IFC-së në financimin e eficiencës energjetike dhe energjisë së rinovueshme me bankën. Me këtë angazhim huajebanka ka do të përdorë 10 milionë euro në EE dhe ER.

- Projekti ka asistuar Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) në rishikimin e draft ligjit për Eficiencën Energjetike dhe në zhvillimin e shtatë akteve ligjore që promovojnë zgjidhje përmes financimit të iniciativave që lidhen me përdorimin eficient të energjisë dhe kursimeve energjetike.
- Projekti zhvilloi një faqe interneti mbi eficiencën energjetike në të cilën listohen masat për arritjen e eficiencës në energji dhe huatë e produkteve në treg. Duke bërë partneritet me agjencitë energjetike, projekti ka organizuar disa workshope në nivel kombëtar për të rritur njohuritë publike mbi përfitimet ekonomike të investimeve me eficiencë energjetike. Zhvillimi dhe shpërndarja e broshurave dhe fletëpalosjeve për të promovuar eficiencën energjetike në më tepër se 11 bashki në Shqipëri.

PARTNERË KYÇ: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Shoqata Shqiptare e Bankave, Institucionet Financiare: Credins Bank sh.a, Societe General Albania, Fondi BESA, NOA
DONATORË: Fonde Austriake (TATF).

Hidroçentralet e Vogla në Shqipëri dhe Energjia e Rinovueshme (ER)

DATAT KRYESORE

Miraturar në: janar 2009

Data e përfundimit: qershor 2017

FINANCIMI NË MILION \$

Financuesi	Financimi
Kontributi i IFC-së	1.7
Kosto totale e projektit	1.7

Ky projekt pesë vjeçar është pjesë e një Programi më të gjerë rajonal në Ballkanin Perëndimor #550626. Programi do të zbatohet në 3 vende të Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Maqedoni. Këto vende ofrojnë potencialet më të mëdha dhe kanë bërë përparim në zbatimin e kuadrit rregullator.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit në Shqipëri është krijimi i një kuadri gjithëpërfshirës për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve për hidroçentralet e vogla (SHPP). Ky qëllim do të arrihet përmes zbatimit të tre objektivave individuale:

1. Përmirësimi i kuadrit ekzistues rregullator për të mundësuar që sponsorat e SHPP të zhvillojnë dhe ndërtojnë SHPP të realizueshme
2. Punojë me sponsorët e SHPP-ve për të përmirësuar dizajnet e tyre dhe planet e biznesit
3. Punojë me institucionet e përzgjedhura financiare në Shqipëri për të përmirësuar kapacitetet e brendshme si edhe dijet mbi SHPP-të dhe financimin e projekteve.

Impaktet e pritshme janë lehtësimi i të paktën 90 milionë \$ investimeve në ndërtimin e SHPP; mbështetja për ndërtimin e 30 SHPP-ve me një kapacitet total të instaluar prej 60 megavatësh dhe shmangia direkte e 0.15 metrik ton emetimesh të CO₂në vit.

Rezultatet e arritura

- Projekti mbështeti Ministrinë e Energjetikës në përgatitjen e paketës rregullatore të energjisë së rinovueshme (Ligji i Energjisë së Rinovueshme, amendamentet e Ligjit të Koncesionit, Marrëveshja Standarde e Blerjes së Energjisë, Marrëveshja e Standardizuar për Lidhjen e rrjeteve, Kontrata e Standardizuar për Koncesionet, Instruksionet e Ministrisë për Kriteret e Para-kualifikimit dhe Përzgjedhjes për Kapacitetet e Tenderimit të SHPP) për të krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e projektit të energjisë së rinovueshme dhe zbatimin me fokus tek SHPP-të në Shqipëri. Ligji ER u miratua në maj 2013. Projekti ka organizuar workshope ndërmjet bizneseve, duke bashkuar investitorë ndërkombëtarë dhe lokalë në sektorin e energjisë së rinovueshme për të promovuar investimet e huaja direkte (FDI) në këtë sektor. Projekti po punon gjithashtu me ENSO GMBJ (një SHPP) për aprovimin e një Programi Aktivitetesh (PA) për Shqipërinë dhe Serbinë (projekte ombrellë) në procesin e



regjistrimit të mekanizmave të zhvillimit të pastër (CDM) me UNFCCC Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Kuadrin e Ndryshimeve Klimatike. Plani i Aktiviteteve për kompaninë ENSO u regjistrua në korrik 2013.

- Projekti po punon me dy Banka, (Intesa Sanpaolo dhe Credins Bank) për të rritur kapacitetet e tyre të brendshme në analizën e vlerësimit financiar të projektit të SHPP për të mbështetur strategjinë e vendit për sektorin e Energjisë së Rinovueshme. Paketa këshilluese përfshin: (i) trajnim të thellë të stafit ii) Manuale vlerësimi të ER dhe iii)

një vlerësim të tre projekteve SHPP, duke rritur kapacitetet e brendshme të stafit të bankave për t'u angazhuar me huadhënie të SHPP-ve. Një workshop në nivel vendi u organizua gjithashtu bashkë me Shoqatën Shqiptare të Bankave, që ka për qëllim promovimin e investimeve në sektorin e Energjisë së Rinovueshme.

PARTNERË KYÇ: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë (UCCIALAlbania); Enso Hidro Energji sh.p.k; Credins Bank sh.a

DONATORË: Ministria Austriake e Financave

Shqipëria: Projekti i IFC-së në Ballkanin Perëndimor për Logjistikën e Tregtisë

DATAT KRYESORE

Miratuar në: 1 shtator 2011

Data e përfundimit: 30 qershor 2014

FINANCIMI NË MILION \$

Financiuasi	Financimi
Komisioni Evropian	2
Kosto totale e projektit (Rajonale)	2
Kosto totale e projektit për Shqipërinë	0.35

Ky projekt është pjesë e Programit të Logjistikës së Tregtisë në Ballkanin Perëndimor dhe operon në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi dhe Serbi. Objektivi i programit është të përmirësojë konkurrueshmërinë e sektorit privat në rajon, përmes aksesit më eficient tek tregjet rajonale dhe globale.

Kjo pritet të arrihet duke reduktuar pengesat administrative ndaj tregtisë ndërkufitare në rajon, përmes procedurave më dinamike të eksporteve, importeve dhe tranzitit; duke harmonizuar bashkëpunimin ndërmjet agjencive në vend dhe ndërmjet vendeve të ndryshme dhe duke përdorur më tepër sisteme elektronike për shkëmbimin e të dhënave, kontrollet e bazuara tek risku dhe pagesa që lidhen me logjistikën e tregtisë.

Rezultatet e pritshme të zbatimit të projektit pritet të arrijnë 10 milionë \$ kursime për sektorin privat.

Objektivat:

- Reduktimi i numrit të dokumentave dhe ditëve që nevojiten për eksportin dhe importin e produkteve
- Thjeshtimin e procedurave për lëvizjen e kargove përmes rrugës, ajrit apo lumit.

Rezultatet e arritura:

- Identifikimi i pengesave në logjistikën e tregtisë dhe diskutimi i zgjidhjeve të mundshme me palët përkatëse
- Fillimi dhe lehtësimi i procesit (takime 1-vjeçare) për një Marrëveshje Lehtësimi Tregtie ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës për tranzitin e prodhimeve që vijnë nga portii Durrësit dhe kanë Kosovën si destinacion. Marrëveshja u nënshkrua nga të dy qeveritë në 11 janar 2014 gjatë takimit të parë të përbashkët qeveritar.
- Fillimi i negociatave ndërmjet doganës dhe bankave sa i përket sistemit të e-pagesave për tregtarët, në mënyrë që të reduktohet koha e transaksionit. Doganat lëshuan një sistem e-pagese në maj 2013.
- Trajnime për vlerësimin e risqeve dhe konferenca rajonale ofruar për stafin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për të ndërtuar kapacitetet e inspektorëve të ushqimit.

Hapat e mëtejshëm:

- Këshillimi i Ministrisë së Ekonomisë mbi



Planin e Veprimit për tëzbatuar marrëveshjen e lehtësimit të tregtisë (harmonizimi i legjislacionit, shkëmbimi i informacionit, thjeshtimi i procedurave të tranzitit, përmirësimi i sistemit doganor)

- Këshillimi i Doganës së Shqipërisë mbi përmirësimin e sistemit botëror ASYCUDA duke bashkëpunuar me Kombet e Bashkuara
- Konferencë mbi Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD).

- Këshillimi i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit mbi Vlerësimin dhe Manaxhimin e Riskut.

PARTNERË KYÇ: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Marrëveshja e Bashkëpunimit e nënshkruar në maj 2013 me Ministrinë e Ekonomisë (50 000 tarifa kesh)

Shqipëria: Programi i Evropës Juglindore për Transparencën dhe Thjeshtëzimin e Taksave

DATAT KRYESORE

Miratuar në: Dhjetor 6, 2012

Data e përfundimit: Qershor 30, 2015

FINANCIMI NË MILION \$

Financiuessi

Sekretariati Shtetëror për Punët Ekonomike (SECO)

Kosto totale e projektit (rajonale)

Financimi

2.88

3

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të përmirësojë përputhshmërinë e taksave duke rritur transparencën dhe thjeshtëzimin e procedurave të administrimit të taksave. Programi i Evropës Juglindore për Transparencën dhe Thjeshtëzimin e Taksave do të punojë në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbi për të arritur dy objektiva:

1. Thjeshtimin e procedurave për administrimin e taksave për të reduktuar kostot e pajtueshmërisë së taksave, veçanërisht për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme.

2. Përmirësimin e kuadrit ligjor dhe efikasitetit të administratës të procedurave të taksimit ndërkombëtar, me një fokus tek Transferimi i çmimit (dhe traktatet e Taksimit të Dyfishtë).

Rezultatet e arritura:

- Sondazhi për Koston e Tax Compliance (800 biznese)
- Bërja e hartës për “si është” dhe “si duhet të jetë”, 12 procedura të administrimit të taksave
- Rekomandime të sondazhit dhe hartës u ndanë me qeverinë, çka rezultoi në 8 ndryshime ligjore në paketën fiskale të 2014
- U përfundua Vlerësimi i Nevojave për Transferimin e Çmimeve (Transfer Pricing Needs Assessment)
- Është draftuar legjislacioni primar dhe dytësor

për Transferimin e Çmimeve, konsultuar me qeverinë dhe opozitën

- Trajnime dhe aktivitete rajonale mbi Traktatet për Transferimin e Çmimeve dhe Taksimin e Dyfishtë janë ofruar për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe stafin e Ministrisë së Financave
- Janë organizuar disa aktivitete rajonale për ndërtimin e kapaciteteve me fokus tek traktatet e taksimit, në të cilat kanë marrë pjesë stafi i Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Hapat e mëtejshëm:

- Ndërtimi i kapaciteteve për stafin e administratës tatimore si mbi procedurat e thjeshtimit ashtu edhe mbi transferimin e çmimeve
 - Draftimi i Marrëveshjeve për Avancimin e Çmimeve
- Hapat e ardhshëm:
- Ndërtimi i kapaciteteve për administratën tatimore si për procedurat e thjeshtimit ashtu edhe për çmimet e transfertave
 - Draftimi i Marrëveshjeve të Çmimeve të Avancuara
 - Aprovimi i legjislacionit për transfertën e çmimeve në 6 muajt e ardhshëm

PARTNERË KYÇ: Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Marrëveshja e Bashkëpunimit e nënshkruar në mars 2013 me Ministrinë e Financave (50 000 \$ tarifa kesh të mbledhura).

Shqipëria: Zgjidhja e borxhit

DATAT KRYESORE

Miratuar në: Qershor 2012

Data e përfundimit: Dhjetor 2015

FINANCIMI NË MILION \$

Financiuesi

IFC

Kostoja Totale e Projektit për Shqipërinë

Financimi

0.75

Rezultati i pritur i zbatimit të Programit të Ballkanit Perëndimor në Shqipëri është që sistemi i zgjidhjes së borxhit të bëhet më efikas duke përmirësuar kuadrin dhe praktikën e paafësisë paguese që do të çojë në një rrugë të përforcuar zgjidhjen e huave të këqija, rritjen e rikthimit tek kreditorët si edhe mbrojtjen ekonomike të kompanive të besueshme.

Objektivat:

- Të asistohen autoritetet shqiptare në thjeshtimin dhe përmirësimin e legjislacionit të pazgjidhshmërisë
- Të zhvillohen dispozita për njohjen e shpejtë të punimeve të negociuara jashtë gjykatës për korvizën shqiptare
- Të forcohet roli i Agjencisë Shqiptare për Mbikqyrjen e Falimentimit (ASHMF) dhe të rritet cilësia e profesionit të administratorit të falimentimit
- Të ofrohet trajnim dhe të rritet ndërgjegjësimi ndër aktorët kryesorë.

Rezultatet e arritura

- Misione për identifikimin e pengesave në sistemin e pazgjidhshmërisë dhe mekanizmat e huadhënies
- Rishikimi i legjislacionit të pazgjidhshmërisë dhe rekomandime për përmirësime
- Rishikimi i procedurave të brendshme administrative dhe të funksionimit të ASHMF
- Trajnime për stafin e ASHMF për të mundur transferimin e njohurive, aftësive dhe udhëheqje nga një ekspert i pazgjidhshmërisë nga Mbretëria e Bashkuar
- Draftimi i një Plani të detajuar Veprimi që do të dorëzohet tek ASHMF

Hapat e ardhshëm:

- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit (50 000 \$ tarifa kesh)
- Rënia dakord mbi Planin e Veprimit
- Fillimi i zbatimit të Planit të Veprimit

PARTNERË KYÇ: Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Shqiptare e Mbikqyrjes së Falimentimit
Memorandumi i Mirëkuptimit nënshkruar në tetor 2012 me Ministrinë e Drejtësisë.

Shqipëria: Enso Hydro Energji

DATAT KRYESORE:

Miratuar në: Shkurt 2012

FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesi	Financimi
Kapitali i IFC-së	8.4
Kosto totale e projektit	105

IFC-ja investoi 6 milionë \$ për 20% të aksioneve në Enso Hidro Energji për të ndihmuar në ndërtimin e një serie projektsh hidrike në Shqipëri. Ky investim do të rrisë gjenerimin e elektricitetit të vendit dhe reduktimin e importeve të energjisë. Zhvilluesi austriak Enso Hidro themeloi Enso Hidro Energji për të zhvilluar hidrocentrale të vogla dhe të mesme në Shqipëri. Gjatë periudhës 2012-2015, kompania ka për qëllim të investojë rreth 75 milion euro në vend për të ndërtuar hidrocentrale të reja që do të kenë kapacitetin për të prodhuar rreth 50 megavat hidroenergji. Ky investim mbështet strategjinë tonë për Shqipërinë për të stimuluar investimin tek burimet e energjisë së rinovueshme si hidroenergji.

Rezultatet e arritura

- Projekti ndihmon në reduktimin e pengesave infrastrukturore për të stimuluar rritjen ekonomike të Shqipërisë.
- Projekti mbështet zhvillimin e një sektori energjetik të qendrushëm që varet më pak tek importet e kushtueshme dhe për rrjedhojë përmirëson konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare.
- Suksesi i projektit do të dërgojë gjithashtu një sinjal të fortë mbështetjeje për reformimin e vazhdueshëm të sektorit energjetik që është kritik për suksesin afatgjatë të këtij sektori.
- Projekti mbështet zhvillimin e projekteve të gjenerimit të energjisë bazuar tek energjia e rinovueshme dhe ndihmon në mbështetjen e ruajtjen e ujit në digat hidroenergjetike duke e rritur prodhueshmërinë në hidrocentrale të llojit që vendosen mbi lumenj.

PARTNERË KYÇ: Enso Hidro Energji.

Shqipëria: Banka Credins

DATAT KRYESORE:

Miraturar në: Gusht 2012

FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesi	Financimi
IFC	10
Kosto totale	10

Projekti përfshin një hua prej 10 milionë euro në energji të rinovueshme ER për Bankën Credins, bashkë me asistencën teknike për ER dhe qeverisjen e korporatave si edhe mbështetje për manaxhimin e riskut. Qëllimet kryesore të angazhimit të Shërbimeve Këshillimore përfshijnë: (i) ndërtimin e kapaciteteve operacionale të bankës për të zhvilluar dhe lëshuar produkte të zbatueshme huadhënieje dhe të mbështesë financimin e hidrocentraleve të vegjël (SHPP) (ii) rritjen e njohurive të bankës në ER/SHPP dhe financimin e projekteve, (iii) ofrimin e mbështetjes fillestare për vlerësimin e projektit SHPP dhe vlerësimin dhe monitorimin si edhe (iv) mbështetjen e bankës në përmirësimin e sistemeve të manaxhimit të riskut dhe auditimin e brendshëm.

Rezultatet që do të arrihen:

- Lehtësimit i zhvillimit të investimeve në efikasitetin energjetikë përmes rritjes së financimit të disponueshëm për klientët rezidentë dhe sipërmarrjet potenciale të vogla dhe të mesme (SME);
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare duke rritur efikasitetin e përdorimit të energjisë përgjatë sektorëve të ndryshëm;
- Rritja e huadhënies për projektet ER në Shqipëri me fokus specifik tek SHPP-të;
- Përmirësimi i mjediseve lokale dhe globale përmes uljes së emetimit të gazrave serë dhe ndotës të tjerë konvencionalë duke reduktuar ndërkohë varësinë e vendit tek eksporti i energjisë.

PARTNERË KYÇ: Banka Credins.

Shqipëria: Bankers Petroleum

DATAT KRYESORE:

Miraturar në: Shator 2009

FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesi	Financimi
IFC	55
BERZH	55
Kosto totale	370

IFC-ja dhe BERZH bashkëfinancuan projektin dhe kanë dhënë 10.4 milionë \$ në kapital dhe 30 milionë \$ në hua për projektin, si edhe afërsisht 5 milionë \$ secila në formën e një huaje me qëllim special mjedisor.

Projekti përfshin ri-zhvillimin e mëtejshëm të fushës së naftës Patos Marinzë në jug të Shqipërisë. Kostoja e përlogaritur e projektit është 370 milionë \$ dhe përfshin: (i) zgjerimin dhe riaktivizimin e puseve ekzistuese në fushë dhe (ii) shpimine puseve të reja horizontale dhe vertikale dhe mbajtjen e testimit paralel dhe aplikimin e strategjive shtesë, duke përfshirë përmbytjet dhe stimulimin e avujve ciklik, për të rritur më tej rimëkëmbjen e naftës. Koha e përlogaritur e projektit është 5 vite, në varësi të çmimeve të naftës.

Rezultatet e arritura:

- Investimi ndihmoi në promovimin dhe integrimin e praktikave më të pastra dhe më të qëndrueshme në prodhimin e naftës në Shqipëri.
- Projekti ndihmoi në përshpejtimin e prodhimit të brendshëm të naftës dhe shifrat e rimëkëmbjes nga burimet ekzistuese në vend.
- Projekti ndihmoi për të çuar më tej zhvillimin e aftësive lokale dhe transferimin e dijeve dhe

teknologjisë për nxjerrjen e naftës së rëndë në Shqipëri.

- Projekti ka kontribuar në rritjen e të ardhurave të qeverisë.
- Shitjet e naftës mesatarisht arrijnë 14000 fuçi naftë në ditë duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2012, që është një rritje prej 17% krahasuar me vitin e mëparshëm.
- Prodhimi i fortë është përkthyer në pagesa besnike ndaj qeverisë shqiptare. Për shembull, në vitin 2011, 67 milionë \$ iu paguan qeverisë shqiptare dhe entiteteve që lidhen me të krahasuar me 23 milionë \$ që pritej kur u krye transaksioni.
- Bankierët hartuan dhe përfunduan një projekt rehabilitimi në vitin 2011 për të pastruar ndotjen historike.
- Plane të mëtejshme përfshijnë rehabilitimin e zonave të ndotura në zonën e projektit, zbatimin e planeve për manaxhimin e mbetjeve të ngurta si edhe pastrimin mjedisor të një prej gropave historike ekologjike.

PARTNERË KYÇ: Bankers Petroleum; BERZH.

Shqipëria: Union Bank

DATAT KRYESORE:

Miraturar në: Maj 2013

FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesi	Financimi
IFC	4
Kosto totale	4

Projekti është në linjë me Strategjinë e IFC për Shqipërinë, që ka të bëjë me ndërtimin e partneriteteve me klientë në sektorë strategjikë që i shërbejnë zhvillimit të qendrueshëm dhe afatgjatë të vendit. Për shkak të niveleve të larta të likuiditetit në këtë sektor dhe prezencës dominuese të aktorëve të huaj që kontrollojnë 90% të tregut, IFC është fokusuar tek bankat lokale që mund të përfitojnë nga ekspertiza e IFC-së në produktet e specializuara, si për shembull tregtia financiare, energjia e rinovueshme/efiçienca energjetike etj. Projekti është gjithashtu në linjë me objektivin e Grupit të Bankës Botërore për të lehtësuar fluksin e tregtisë pas krizës.

Rezultate që do të arrihen:

- Të ofrohen garanci për mbështetjen e operacioneve të tregtisë financiare të bankës dhe të lejohet banka të lirojë kapital dhe të ulë kostot;
- Të sinjalizojë besim në bankë dhe potencialisht të fitojë mbështetje nga banka të tjera tregtare që janë të gatshme të punojnë me Union Bank si banka që emetojnë para;
- Të mbështesë operacionet e tregtisë financiare të bankës në një kohë kur linjat e tregtisë financiare po shkurtohen;
- Të mbështesë ndërmarrjet e sektorit privat që varen tek tregtia financiare për të mbijetuar.

PARTNERË KYÇ: Union Bank.

Shqipëria: Kurum International

DATAT KRYESORE:

Miratuar në: Korrik 2013

FINANCIMI NË MILION \$:

Financuesi	Financimi
IFC	44.2
Kosto Totale e Projektit	156

Huaja është për Kurum International Sh.A. për financimin e: (a) blerjes nga privatizimi i katër hidrocentraleve që gjenden në Shqipëri me një kapacitet total të instaluar prej 76.5 megavat dhe (b) investimin e rehabilitimit të këtyre centraleve. Kosto totale e projektit llogaritet të jetë 120 milionë euro, prej të cilave 109.5 milionë euro do të mbulojnë shumën që do të paguhet për privatizimin dhe pjesa tjetër do të përdoret për rehabilitimin. Projekti sponsorizohet nga Kurum Holding AS, një kompani turke e nivelit të tretë që operon në industrinë e hekurit dhe çelikut. Elektriciteti që do të prodhohet do të konsumohet kryesisht prej centralit të çelikut të kompanisë në Shqipëri, që është një prej kompanive më të mëdha industriale në vend, duke siguruar kështu një input të fuqishëm energjie për centralin, i dyti më i rëndësishmi pas skrapit.

Rezultatet që do të arrihen

- Mbështetja e reformave të sektorit energjetik duke rritur pjesën e sektorit privat në gjenerimin e përgjithshëm të elektricitetit në Shqipëri
- Ndihma në liberalizimin e tregut energjetik në Shqipëri dhe promovimi i pjesëmarrjes së sektorit privat
- Lehtësimi i lëvizjes drejt krijimit të tregut energjetik rajonal në Evropën juglindore
- Rritja e investimeve të huaja direkte dhe promovimi i investimeve rajonale
- Lehtësimi i ndryshimeve klimatike (rritja e gjenerimit të energjisë së pastër duke përmirësuar eficiencën)

PARTNERËT KYÇ: Kurum International SH.A.

PROJEKTET MIGA

Shqipëria: Energji Ashta Shpk (ASHTA)

ID e projektit: 7869

Viti fiskal: 2012

Statusi: aktiv

Mbajtësi i garancisë: EVN, AG

Vendi investees: Austria

Vendi pritës: Shqipëria

Kategoria mjedisore: A

Sektori: Energjetika

Data e hapjes: 7 nëntor 2011

Daya e bordit të projektit: 31 janar 2012

Ekspozimi bruto: 159.4 milionë \$

Lloji i projektit: Non-SIP

Fusha strategjike prioritare: Projekt Kompleks

ESRS: Përmbledhja mjedisore dhe sociale për Energji

Ashta Shpk në Shqipëri

Në 1 shkurt 2012, Agjencia Multilaterale për Garanti-min e Investimeve (MIGA) lëshoi garanci që arrinin një total prej 121.4 milionë euro (159.4 milionë \$) ndaj EVN Ag e Austrisë për investimet e saj tek Energji Ashta shpk në Shqipëri. Mbulimi i MIGA-s vlen deri në 20 vjet për investimet e saj kapitale dhe deri në 10 vjet për huatë e saj të garancisë. Mbulimi sigurohet kundrejt rrezikut për kufizimin e transferimit, shpronësimin, luftë dhe shqetësime civile si edhe shkeljen e kontratës.

Projekti përfshin rikonstruksionin e një hidrocentrali prej 52.9 megavat në baza ndërto, zotëro, opero dhe transfero nën një marrëveshje koncesioni prej 35 vitesh që fillimisht hyri në fuqi ndërmjet VERBUND AG dhe Ministrisë së Ekonomisë të Shqipërisë. Në vitin 2010, dy sponsorët e projektit, EVN AG dhe VERBUND AG, negociuan një marrëveshje aksionarësh për të zhvilluar dhe zbatuar një projekt sëbashku.

Ky projekt është hidrocentrali i tretë mbi lumin Drin, por i pari që ndërtohet këto 30 vitet e fundit. Vendodhja e tij është në qarkun e Shkodrës në veri-perëndim të Shqipërisë. Zhvilluesit kanë nënshkruar marrëveshje me furnizuesin publik të shitjeve me shumicë në Shqipëri, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare Sh.A (KESH). Projekti pritet të ketë impakt të lartë zhvillues duke siguruar energji të pastër dhe të rinovueshme ndërkohë që ndihmon në lehtësimin e ndërprerjes së energjisë elektrike afatmesëm dhe afatgjatë. Projekti do të reduktojë gjithashtu importet dhe reduktimet e elektricitetit. Projekti përshtatet me Strategjinë e Bankës Botërore për Shqipërinë. Një prej tre objektivave strategjike të kësaj strategjie është përshejtimi i rimëkëmbjes ekonomike të Shqipërisë përmes shërbimeve të përmirësuar dhe financiarisht të qëndrueshme infrastrukturore si rrugët, energjetika dhe ujitja. Në sektorin energjetik, strategjia fokusohet tek konsolidimi i reformave aktuale dhe përfundimi i projekteve të nisura, duke promovuar ndërkohë mekanizma të reja financimi privat.

Shqipëria: Mbulimi i Detyrueshëm i Rezervave të Grupit ProCredit nga Banka Qendrore

ID e projektit: 9186
 Viti fiskal: 2011
 Statusi: Aktiv
 Mbajtësi i garancisë: Procredit
 Vendi investues: Gjermania
 Vendi pritës: Shqipëria
 Kategoria mjedisore: FI

Sektori: Bankar
 Date SPG disclosed: October 05, 2010
 Data e Bordit të projektit: 23 nëntor 2010
 Ekspozimi bruto: 25.0 milionë \$
 Lloji i projektit: Non-SIP
 Fusha strategjike prioritare: Projekt kompleks

Në 22 dhjetor 2010, MIGA dha një garanci prej 25 milionë \$ për ProCredit Holding (PCH) duke mbuluar investimin e tij në filialin në Shqipëri. Mbulimi vlen për një periudhë deri në 10 vite kundrejt rrezikut të shpronësimit për fondet për rezervat e detyrueshme të mbajtura nga filiali në bankën qendrore të juridiksionit të saj.

Ky projekt është pjesë e një kontrate madhore që MIGA ka nënshkruar. PCH i ka zyrat qendrore në Gjermani dhe është kompania mëmë e 21 bankave (Grupi ProCredit). Grupi ProCredit është sigurues i financave për rreth 750000 sipërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme në Amerikën Latine, Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Afrikë. Në të gjithë botën bankave u kërkohet të ruajnë rezerva të detyrueshme me bankën qendrore të juridiksionit të tyre përkatës. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të grupit ProCredit përlllogaritet sipas Aktit Bankar Gjerman. Sipas këtij akti, në një nivel të konsoliduar, rezervat e depozituara tek bankat e ndryshme qendrore mund të tërheqin një rrezik që arrin 100 madje edhe 150% në varësi të vendit. Peshimi i rrezikut përcakton shumën e kapitalit të kërkuar për të ruajtur një raport specifik në përputhje me Aktin Bankar Gjerman.

Garancia e lëshuar nga MIGA do të ndihmojë PCH-në të marrë lehtësim kapitali nga kërkesat e CAR. Duke marrë fi-

nancimin e MIGA's kundër rrezikut të shpronësimit të fondëve, peshimi i riksut për rezervat e detyrueshme mbajtur tek Banka Qendrore mund të reduktohet. Një peshim risku më i ulët do të lejojë PCH-në të lirojë kapitalin që për momentin është i lidhur për qëllimet e mirëmbajtjes së CAR-it, duke lejuar kështu që këto fonde të injektohen në bankat filiale. Në këmbim kjo do të lejojë tregun në zhvillim të bankave filiale të PCH-së nëpër të gjithë rrjetin, të rrisin aktivitetet huadhënëse.

Mbështetja e MIGA's do ta ndihmojë PCH-në të optimizojë manaxhimin e saj të kapitalit nëpër të 21 bankat, duke e lejuar kështu PCH-në të drejtojë kapitalin tek filialet me nevojën më të madhe. Këto banka do të mund të ofrojnë shërbime shitesë financiare ndaj sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme në një kohë sfidash makroekonomike. Mbështetja e bizneseve të vogla produktive do të ndihmojë në stimulimin e rritjes, gjenerimin e punësimit dhe reduktimin e varfërisë.

Mbështetja e MIGA's për këtë projekt është në përputhje me strategjinë e Grupit të Bankës Botërore për mikrofinancimin, që përfshin përmirësimin e furnizimit të mikrofinancës; rritja e kapaciteteve të depozitimit duke asistuar institucionet e mikrofinancës në mobilizimin e kursimeve; promovimi i ndërtimit të kapaciteteve; krijimi dhe formësimi i tregjeve dhe nxitja e inovacionit.



Shqipëria: Giorgi Alfo SH.P.K.

ID e projektit: 1163

Viti fiskal: 2000

Statusi: aktiv

Mbajtësi i garancisë: Ge/Por.Tur.s.a.s.

Vendi investitor: Italia

Vendi pritës: Shqipëria

Sektori: turizmi

Totali bruto: 1.6 milionë \$

Lloji i projektit: Non-SIP

Në projektin e saj të parë në Shqipëri, MIGA dha një garanci prej 1.6 milion \$ për Ge.Por..Tur.s.a.s. për investimet e saj kapitale në Giorgi Alfo Sh.p.k, Ge.Pot.Tur do të hartojë, ndërtojë dhe operojë një marinë turistike- duke përfshirë një kabinë, restorant, supermarket, klub jahti dhe spirancë për varkat- në jug të bregdetit shqiptar. Garantuesi sigurohet kundër rreziqeve të konfiskimit.

Projekti është një kontribut ndaj përpjekjeve të udhëhequra nga Banka Botërore dhe Komisioni Evropian në Ballkan pas luftës së Kosovës, që shkaktoi ndërprerje të mëdha në tregti, infrastrukturë dhe turizëm në vendet fqinje.

Qeveria shqiptare pret që turizmi të kthehet në një burim të madh të ardhurash. Marina e parë në bregdetin shqiptar do të jetë një hap modest drejt arritjes së këtij qëllimi- pritet që do të ndihmojë të plotësohen kërkesat në rritje nga vendet evropiane për portet turistike në jug të detit Adriatik. Pritet gjithashtu që të krijohen vende pune dhe trajnime të përhershme për rreth 50 qytetarë vendas. Në hartimin e tij, porti është sensitiv ndaj mjedisit, pasi minimizon dëmtimin e peizazhit për të ruajtur bukurinë e vijës bregdetare.

